



NEWS SOT

Themeluar në 26 Tetor 2002
Çmimi 30 lekë
E Mërkurë 3 Korrik 2024

SIGMA
INTERALBANIAN
VIENNA INSURANCE GROUP

Ja si ka ndryshuar ndër vite pasuria e **Belinda Ballukut**, nga llogaritë bankare, apartamentet deri në Angli dhe 127 mijë euro nëpër duar që deklaronte, deri te “varfëria” që e ka kapur në vitet e fundit, tani jeton vetëm me pagën dhe honoraret si ministre **Page 8**

Orë ankthi për politikën shqiptare, ambasadori i ri i SHBA merr mandatin më 5 korrik nga Senati, Kreshnik Spahiu paralajmëron se Yuri Kim do t’iu duket lule të korrupsuarve **Page 2**



Rrëfimi tronditës i Petro Koçit për zgjedhjet e përgjakura të vitit 1994: Sali Berisha urdhëroi bandat të hidhnin vëzhguesin në lumë dhe të godisnin socialistët, ja kush është deputeti që për pak i prenë gishtat dhe si kriminelët kursyen vetëm Ilir Metën **Page 4**

Më 11 korrik SPAK vendos për fatin e Sali Berishës dhe Jamarbër Maltezit për aferën “Partizani”, ish-kryeministri dhe dhëndri i tij rrezikojnë deri në 15 vite burg, mbështetësit e tij përgatiten për trazira e kaos, ja skenarët **Page 3**

Ilir Meta dhe Ilir Beqaj dy politikanët më të rrezikuar në SPAK, dosjet e aferave drejt mbylljes, ish-ministri pritet të dënohet për “shpërdorim detyre”, ish-presidenti për “pastrim parash” **Page 5**



Rikthehet ideja e “botës serbe”, rezoluta për Jasenovacin ka tronditur gjithë Ballkanin, si orkestroi Vuçiç planin tinzar që po e zhyt Malin e Zi në një krizë të paprecedentë politike, ja kush janë dy “nxënësit” e tij në Podgoricë **Page 12**



NATO përgatit planin anti-Trump, aktivizon 700 zyrtarë, ja si aleanca po kërkon të mbrojë Ukrainën nga manjati, pse miliarda euro ndihmë rrezikojnë të bllokohen nëse ai vjen në pushtet në nëntor **Page 13**

Drejtoresha e SHISH dëshmon me dyer të mbyllura në Komisionin Hetimor për të dhënat e TIMS dhe hedh poshtë akuzat e opozitës, Saliunji përplasat me Ardi Veliun dhe kalojnë në ofendime, zbardhen debatet mes palëve **Page 6**

Ja si mund të bëhet shumë thjesht rritja e pensioneve të ulëta, lajme të mira edhe për sektorin privat, eksperti i ekonomisë Kujtim Hoxha jep informacionet e rëndësishme **Page 9**

KQZ vihet në lëvizje pas kërkesës së PS, të enjten vendos për mandatin e Fredi Belerit si kryetar i Bashkisë së Himarës, ja hapat që do të ndiqen dhe kandidatët e mundshëm **Page 7**

KOMENT & ANALIZË **Page 16-18**

Nga Gelsi SELIMPËRTEASI
Misioni për Shqipërinë i Lulzim Bashës

Nga Pirro PRIFTI
Kisha Ortodokse Autoqefale nderon çamët e rënë nga genocidi grek

Nga Qamil GJYREZI
Bashkëpunimi Berisha-Rama, PD-në në opozitë, Rama në 2025 dhe Veliun në 2029 Kryeministër?!

Nga Vladimir SHYTI
Profesioni, trashëgimi e shqiptarëve

Nga Ekrem SPAHIU
2025: T’u kthehet zgjedhësve besimi te vota e tyre. Boll më!

RAJON & BOTË

“Tërmet” politik në SHBA, demokratët të alarmuar duan që Joe Biden të tërhiqet nga gara presidenciale këtë javë, vihet në lëvizje Shtëpia e Bardhë **Page 15**

Franca në kaos, Macron hap të gjitha kartat, një “grusht-shteti” mund të ndalojë fitoren e Le Pen, ja pakti me ish-armikun që mund të shpëtojë presidentin francez **Page 14**

politikë

Ja kush është David Kostelancik që i ka shpallur luftë korrupsionit

Orë ankthi për politikën shqiptare, ambasadori i ri i SHBA merr mandatin më 5 korrik nga Senati, Kreshnik Spahiu paralajmëron se Yuri Kim do t'iu duket lule të korruptuarve

Elmas BOGDANI

Duket se pas një kohe shumë të gjatë që nga largimi i Yuri Kim, më në fund në Tiranë e trazuar politike nga hetimet e drejtësisë së re të financuar nga amerikanët, do të kemi një ambasador fuqiptotë të SHBA në Shqipëri. Senati amerikan në faqen e tij zyrtare ka publikuar dje kalendarin për punimet e radhës që do të mbajë. Mes dhjetëra çështjesh që do të votohen në seancën e datës 5 Korrik 2024, pritet edhe emërimet e katër ambasadorëve, mes të cilëve është edhe David J. Kostelancik, nga Illinois. Në këtë publikim shtohet se dosja e emërimit të ambasadorit të ri të Shqipërisë në Senat është raportuar më 17 Prill 2024 nga Z. Cardin. Komisioni për Marrëdhëniet me Jashtë.

Paralajmërimi i Kreshnik Spahiut

Me emërimin e tij, zyrtarët e përfshirë në afëra dhe që po hetohen nga Prokuroria e Posaçme i presin ditë të vështira. Një paralajmërim të tillë e ka bërë këtë fundjavë edhe analisti i njohur, Kreshnik Spahiu. Në një intervistë për "Report Tv", zoti Spahiu tha se ambasadori i ri i SHBA do të jetë më i ashpër, sa Yuri Kim do t'iu duket lule të korruptuarve. "SHBA është garanti i sovranitetit, pavarësisë dhe paqes ne shume vende të botës. Pa SHBA nuk do kishte shtet Kosovë. Pa SHBA nuk do kishte Ukrainë.



Pa SHBA nuk do ekzistonte shume shtete. Pa SHBA edhe BE do ishte e pasigurt. Kombe të vegjël apo shtete të dobëta si Shqipëria e kanë sovranitetin dhe paqen e kushtëzuar nga partnerët strategjikë. Pa SHBA, Shqipëria do rrëshqiste në luftë civile në 1997. Ky fakt është i pamohueshëm. Shqiptarët janë kombi më pro amerikan në botë dhe Amerika është shteti më pro shqiptar në Ballkan. Ekzistenca jonë varet nga Amerika. Më gjëni një popull në botë që Amerika t'i njohë si dy shtete me një popullsi të vogël 5 milionë banorë të dyja si Shqipëri-Kosovë? Kjo ka ndodhur vetëm se Amerika kërkon fuqizimin e shqiptarëve. Në planetin tonë ka kombe me 100 milionë banorë që s'ju njihet as e drejta shtet-formuese dhe as autonomia lokale, dhe Amerika nuk i përkrah. Duhet të kuptojmë që SHBA na ka privilegjuar në raport me të tjerët. Korriku do jetë një kapitull i ri. Ardhja

e ambasadorit të ri amerikan David J. Kostelancik do hapë një fazë të re. Ai është nivel i lartë përfaqësimi dhe ka lidhje të forta me Shqipërinë. Ardhja e tij është mision historik për ndërrimin e elitave politike në Shqipëri, thyerjen e establishmentit vjetër, ndëshkimin e zyrtarëve të lartë dhe mbështetjen e elitave të reja politike. Ata që janë gëzuar kur u largua Yuri Kim, do bëhen shumë pishman kur të përballen me David J. Kostelancik. Pas disa muajve Berishës dhe Metës do ju duket lule Yuri Kim duke krahasuar me rolin aktiv dhe pa kompromis që do ketë David J. Kostelancik", tha Kreshnik Spahiu.

Platforma e David J. Kostelancik

Ndërkohë kujtojmë se David J. Kostelancik, i emëruar nga Presidenti Biden për të shërbyer si Ambasador i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, parashtrroi para Komisionit për

Marrëdhëniet me Jashtë në Senatin e Shteteve të Bashkuara, gjatë seancës së konfirmimit, përparësitë e tij si ambasador. "Nëse konfirmohem në këtë detyrë do të bashkëpunoj me Shqipërinë për të forcuar institucionet demokratike dhe institucionet e drejtësisë. Presidenti Joe Biden e ka përcaktuar luftën ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar si pjesë të strategjisë sonë kombëtare. Kjo është një sfidë kryesore për vendet e Ballkanit Perëndimor", tha zoti Kostelancik. Përparimi i reformës në drejtësi do të ndihmojë përparimin e Shqipërisë drejt integritimit evropian, theksoi ai. Një nga sektorët e bashkëpunimit të ngushtë mes dy vendeve, tha ambasadori i emëruar, do të jetë forcimi i mëtejshëm i partneritetit në mbrojtje. Sulmi kibernetik i Iranit ndaj Shqipërisë në vitin 2022, tha ai, tregoi nevojën për të investuar në infrastrukturë dhe trajnime për të ndërtuar një sistem kibernetik të qëndrueshëm. Shtetet e Bashkuara, tha ai, kanë dërguar ekspertë në Shqipëri për të riparuar dëmet e bëra dhe kanë ofruar 50 milionë dollarë për këtë qëllim. Një përparësi e tretë, theksoi

ai, do të jetë forcimi i klimës së biznesit. Interesat e Shteteve të Bashkuara, tha ambasadori i pritshëm, shërbejnë përmes një tregu transparent Shqipëri. **Kush është Diplomati i njohur, David J. Kostelancik?**

Zoti Kostelancik ka shërbyer në Shqipëri edhe më përpara në periudhën 1992-1994, si përfaqësues i parë për çështjet politike dhe ekonomike në ambasadën e porsahapur amerikane në Tiranë. Para emërimit si ambasador, i shërbente si Këshilltar për Politikën e Jashtme i Shefit të Shtatmadhorisë amerikane, Gjeneralit

Mark Milley. Zoti Kostelancik është një diplomat me një karrierë 30-vjeçare. Ai ka shërbyer dy herë në Ambasadën amerikane në Moskë, në misionet e SHBA-së në

OSBE dhe NATO, si edhe në Ankara të Turqisë. Diplomati Kostelancik, me origjinë nga shteti i Illinois, është diplomuar në Universitetin Northwestern të këtij shteti. Ai flet rusisht, hungarisht, shqip dhe turqisht. Nëse kandidatura e tij miratohet nga Senati, diplomati Kostelancik do të zëvendësojë ambasadorin aktual amerikan në Shqipëri, Yuri Kim.

“ Ardhja e ambasadorit të ri amerikan David J. Kostelancik do hapë një fazë të re. Ai është nivel i lartë përfaqësimi dhe ka lidhje të forta me Shqipërinë ”

Denoncimet e qytetarëve, Balla: Policia Rrugore nuk e bën më syrin qorr

Ministri i Brendshëm, Taulant Balla vlerësoi dje angazhimin e Policisë Rrugore për të evidentuar shkeljet në qarkullim dhe për të reaguar në kohë ndaj denoncimeve të qytetarëve. Balla u shpreh në një postim në rrjetet sociale se Policia Rrugore duhet të rrisë vigjilencën në gjithë territorin e vendit për të garantuar më shumë siguri dhe respektim të rregullave të qarkullimit rrugor. "Qytetarët me të drejtë denoncojnë dhe as ligji nuk toleron automjete me xhama të errësuar. Policia Rrugore nuk e bën më syrin qorr në këto raste, as veshin e shurdhër ndaj zhurmave e normave të palejueshme të shpejtësisë dhe

xhirimit të gomave në qendrat e banuara", u shpreh Balla. Sipas tij, neglizhenca dhe heshtja bashkëfajtojnë me të fortët e lagjes dhe mosreagimi i forcave të rendit ndaj denoncimeve të qytetarëve, janë rreshtim i policisë kundër tyre, kundër shtetit. Balla theksoi se fenomenet e drejtimit të mjetit pas përdorimit të alkoolit apo lëndëve narkotike, janë burimi dhe shkak kryesor aksidentesh. "E vlerësoj angazhimin e Policisë Rrugore Tiranë e cila gjatë shtatë ditëve të fundit ka konstatuar 15 mijë shkelje rrugore, ndër to dhe shumë raste të këtij fenomeni. Presim më shumë rezultate", shkroi dje Balla.

Gonzato: BE-ja mbështetje Shqipërisë në zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale

Përparimi i kohezionit social duke i vënë njerëzit në radhë të parë, duke u ofruar atyre mundësi dhe duke mos lënë askënd pas janë vlera të rëndësishme, thelbësore të Bashkimit Evropian. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë, së bashku me qeverinë shqiptare, falë mbështetjes financiare të Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe ekspertizës së UNICEF-it, nisi Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030. Gjithashtu u diskutua

se si të promovohet më së miri një shoqëri shqiptare gjithëpërfshirëse dhe të sigurohet që qytetarët më të cenueshëm të marrin mbrojtjen që meritojnë. BE do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë drejt përafrimit me standardet e BE-së për një sistem modern, të qëndrueshëm të mbrojtjes sociale për të gjithë. "Si kudo tjetër në Evropë, qytetarët shqiptarë presin të kenë shërbime publike me cilësi të lartë, të aksesueshme, efikase dhe pa korrupsion.

Pranimi në BE përfshin, jo vetëm përafrimin e ligjeve dhe rregulloreve, por edhe respektimin e vlerave të saj thelbësore. Thirrje për një shoqëri të drejtë dhe kohezive që mbrojnë më të rrezikuarit: të rinjtë në rrezik, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, minoritetet dhe gratë nga zonat rurale. BE-ja është e gatshme të mbështesë Shqipërinë në çdo hap në zbatimin e saj të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale", u shpreh dje ambasadori i BE-së, Silvio Gonzato.

Ja akuzat e SPAK ndaj Berishës dhe dhëndrit të tij

Më 11 korrik SPAK vendos për fatin e Sali Berishës dhe Jamarbër Malltezi për aferën “Partizani”, ish-kryeministri dhe dhëndri i tij rrezikojnë deri në 15 vite burg, mbështetësit e tij përgatiten për trazira e kaos, ja skenarët

Elmas BOGDANI

Gjykata e Posaçme shtyu për më 11 korrik, ora 10:00, seancën për informacion 2-mujor në ngarkim të ish-kryeministrit, Sali Berisha dhe dhëndrit të tij, Jamarbër Malltezi, të akuzuar për korrupsion pasiv si pjesë e një hetimi gjatë privatizimit të kompleksit sportiv “Partizani”. Kjo është dhe dita kur Partia Demokratike e drejtuar tashmë edhe me vulë e sigël nga Sali Berisha ka thirrur protestën kombëtare. Deri më tani mbështetësit e “non gratës” kanë paralajmëruar destabilitet nëse nuk lirohet Berisha. I fundit që paralajmëroi trazira ishte ish-ministri i Brendshëm Flamur Noka. “Stabilitet Shqipëria pa zgjidhje politike nuk do të ketë. Ta harrojmë Edi Rama se mund të gëzojë karrigen e sulltanit të Surrelit pa i dhënë zgjidhje situatës politike në vend”, deklaroi ai.

Çfarë pritet të ndodhë më 11 korrik?

Në seancën e djeshme, pritej që Prokuroria e Posaçme t'i komunikonte avokatëve përfundimin ose shtyrjen e hetimeve me 3 muaj të tjerë, pasi përfundoi afati i hetimeve për privatizimin e ish klubit sportiv Partizani, por avokatët pritet të përsërisin kërkesën e tyre për ndryshim të masës së sigurisë “arrest në shtëpi”, vendosur ndaj të dyve. Në një prononcim për mediat, avokati i Berishës, Genc Gjokutaj është shprehur se hetimet për çështjen “Partizani” janë shtrirë në një drejtim që nuk



Çfarë rrezikon Berisha dhe Malltezi?

ka lidhje me korrupsionin. “Ne kërkojmë zëvendësimin e masës sepse mungon çështja në thelb. Këta edhe ta zgjasin afatin, edhe të mos e zgjasin, një çështje që nuk ka një fabul akoma të përshkruar nga prokuroria, sigurisht që nuk duhet zgjatur, por duhet marrë zgjidhja ligjore që është pushimi i hetimeve. Ata duhet t'i thërrasin mendjes se edhe sikur të bëjnë një tjetër zgjatje të sforcuar, ata nuk kanë gjë në inventar në kuptimin e provave. I bëj thirrje që të ndërmarrin një veprim ligjor të duhur njëherë në jetë sepse hetimet janë shtrirë në një drejtim që nuk ka lidhje me korrupsionin”, tha Gjokutaj. Më 18 qershor, gjyqtarja Ilirjana Olldashi vendosi të rrezojë kërkesën e radhës të Sali Berishës e Jamarbër Malltezi për ndryshim të masës së sigurisë, duke i lënë sërish në “arrest shtëpie”. SPAK kërkon që Berisha të qëndrojë nën masën e sigurimit arrest në shtëpi, ndërkohë që avokatët kërkojnë ndryshim mase.

Për pastrimin e produkteve të veprës penale parashikohet 5-10 vite burg, ndërsa kur vepra kryhet në bashkëpunim dhe sjell pasoja të rënda siç është edhe rasti i tjetërsimit të ish-Kompleksit Sportiv Partizani, parashikohet një dënim jo më pak se 15 vjet me burgim. Në kallëzimin penal që Taulant Balla referoi në SPAK në vitin 2020, pretendohet se janë konsumuar veprat penale të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim, të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrjnë funksione publike në bashkëpunim, të falsifikimit të dokumenteve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale si dhe vepra penale e korrupsionit aktiv dhe pasiv. Një pjesë të këtyre veprave penale janë parashkruar për shkak të kohës së gjatë të kryerjes së dyshuar të tyre, pasi operacioni abuziv për tjetërsimin e ish-Klubit Sportiv Partizani

është finalizuar në tetor të vitin 2009. Pastrimi i produkteve të veprës penale është një veprë objekt i ligjit anti-mafia të vitit 2009, i cili parashikon që përveç dënimit të autorit të veprës penale, konfiskohet edhe pasuria që është produkt i veprës penale, në rastin konkret prona publike ish klubi Partizani. Sa i përket veprës penale për korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, akuzat e vetme me të cilën mund të përballet Sali Berisha, parashikohet 4 deri në 12 vite burg. “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimit i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet”.

Lëvizjet e SPAK

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në Tiranë vendosi vitin e kaluar nën sekuestro preventive 16 pasuri të paluajtshme të Malltezi, 6 llogari të tij bankare si dhe kuotat e kapitalit themeltar të tij në tre shoqëri. Malltezi dyshohet se ka kryer korrupsion pasiv në bashkëpunim me vjehrin e tij Sali Berisha, duke shfrytëzuar pushtetin e tij si kryeministër, duke përfituar nga privatizimi i terreneve dhe objekteve sportive, nga ndryshimi i destinacionit nga

zona sportive në zona banimi, shuma të konsiderueshme në cilësinë e investuesit nga shoqëria “Homeplan” sh.p.k., pa investuar në të, si dhe përfitime të marra para se të deklarohesh si bashkörtak në këtë shoqëri. Ndërsa në bashkëpunim me ndërtuesin Fatmir Bektashi, Malltezi dyshohet se ka kryer pastrim të produkteve të veprës penale, duke u paraqitur si investitor në punimet për ndërtimin e bllokut të banesave, ndërkohë që nuk rezultoi të ketë investuar, duke kryer veprime financiare, transaksione të copëzuara, apo në cash, për të fshehur origjinën dhe për të përfituar në mënyrë të paligjshme shuma deri mbi 5 milionë euro. Nga ana tjetër edhe Bektashi dyshohet se ka kryer korrupsion aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë në bashkëpunim me Malltezin, duke i dhënë atij përfitimeve të paligjshme në shuma të mëdha, me qëllimin e përbashkët për të bërë ndërtime në terrenet sportive. Ai dyshohet se në bashkëpunim me Malltezin kanë kryer pastrim të produkteve të veprës penale teksa kanë fshehur origjinën e vërtetë të përfitimeve monetare të parregullta të Malltezi, duke i paraqitur ato si të ardhura të ligjshme nga biznesi. Kompleksi sportiv Partizani me 26 mijë metër katrorë, pronë e ushtrisë, u zëvendësua brenda pak vitesh nga një kompleks pallatesh, për të cilin hetuesit dyshojnë se iu hap rruga përmes korrupsionit pasiv e aktiv nga Sali Berisha, Jamarbër Malltezi dhe Fatmir Bektashi.

Noka dhe Bardhi takime me qytetarët për protestën e 11 korrikut: Ngrini zërin kundër padrejtësive

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Flamur Noka dhe kryetari i Grupit Parlamentar, Gazment Bardhi zhvilluan dje takime me qytetarë të kryeqytetit, në zonën e Pazarit të Ri. Gjatë bashkëbisedimit me qytetarët dhe bizneset e zonës, Noka dhe Bardhi janë njohur me shqetësimet dhe problematikën e shumta që ata hasen gjatë përditshmërisë së tyre apo në ushtrimin e biznesit

në kryeqytet. Teksa shpërndanin fletushka nën moton, “Të bashkuan në betejë”, Sekretari i Përgjithshëm i PD-së dhe Kryetari i Grupit Parlamentar, iu bënë thirrje qytetarëve për pjesëmarrje masive në protestën e thirrur nga opozita e cila do të zhvillohet më datë 11 Korrik ora 20:00, për të ngritur zërin dhe për të kërkuar të drejtat e tyre përballë një pushteti kriminal siç është ai i Edi Ramës.

Protesta e 11 korrikut, Bardhi takim me qytetarët: Shqipëria e para në Europë për numrin e popullatës në pasiguri për ushqim

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazmend Bardhi ka zhvilluar dje takime me qytetarët e Tiranës në kuadër të protestës kombëtare të 11 korrikut. Bardhi së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm, Flamur Noka kanë ftuar banorët t'i bashkohet protestës para kryeministrit në orën 20:00. “Në takimet me qytetarë dhe bizneset

pranë zonës së Pazarit të Ri, Njësia 2 Tiranë, bashkë me Sekretarin e Përgjithshëm të PD Flamur Noka, anëtarët e Kryesisë dhe strukturat drejtuese të degës, kuptuam nga afër padurimin e qytetarëve për tu bashkuar në projektin për ndryshimin e gjendjes në vend dhe për një ekonomi që garanton mirëqenien për çdo qytetar shqiptar. Ekonomia është dështimi më i madh i

Qeverisë së Edi Ramës dhe kryearësyeja për të ngritur zërin e protestuar në 11 Korrik, ora 20:00 përpara Kryeministrit. Shqipëria për shkak të politikave të gabuara të Edi Ramës renditet e para në Europë për numrin e madh të popullatës në pasiguri për ushqim, e krahasueshme vetëm me disa shtete në Afrikë”, shkroi dje Bardhi në rrjetet sociale.

politikë

Vula dhe logoja e partisë në duart e Berishës, Alibeaj: PD u rikthye pronë private, pa asnjë shpresë për shqiptarët, të ndahemi nga berishizmi

Enkelejd Alibeaj në një intervistë për një media, foli dje për divorcin e tij politik me Sali Berishën, pasi ky i fundit mori logon dhe vulën e PD-së me vendim gjykatë. Ai u shpreh se bëri përpjekje deri në momentin e fundit për ta rinovuar PD që të mos rikthehej edhe një herë 30 vite më parë, një parti e njëshite, pronë private pa asnjë lloj shprese tashmë për të qenë

shpresë për shqiptarët. Më tej Alibeaj tha se PD u rikthye pronë private pa asnjë lloj shprese tashmë për të qenë shpresë për shqiptarët. “Besoj ky është një konsensus i thënë nga të gjithë, jo vetëm nga unë dhe Basha, por edhe shumë të tjerë. Po them gjënë tjetër e shpjegova edhe pak më parë, nuk ishte thjesht dhe vetëm një ankim juridik e bërë nga juristi Enkelejd Alibeaj.

Nuk lexohet një parti si një studio legale, çdo akt juridik, ankimi ishte një i tillë, kishte një synim politik. Përpjekje të bëra deri në momentin e fundit për ta rinovuar PD që të mos rikthehej edhe një herë 30 vite më parë, një parti e njëshite, pronë private pa asnjë lloj shprese tashmë për të qenë shpresë për shqiptarët. Me rrezikun e madh që mesa duket nuk përbën një ofertë

të re sot për publikun shqiptar ndaj ishte një detyrim i natyrës politike për t’u lexuar kështu. Koha politike ecën shumë më shpejt se sa rregullat procedurale. Lidhur me rekursin, unë do të isha dakord për ta bërë rekursin vetëm për një arsye, thjesht për të testuar sistemin, nuk do shpresoja asgjë më shumë se sa kaq”, deklaroi ai. Ndërkohë Enkelejd Alibeaj

deklaroi se rruga e vetme është ndarja totale nga berishizmi. Alibeaj tha se Sali Berisha nuk përbën më ofertë për shqiptarët, në mënyrë që të ketë mundësi të sfidojë ofertën e kryeministrit Edi Rama. Në lidhje me Partinë Demokratike, ai tha se nuk do duhet të mbarte brenda një individ që ka një peshë të rëndë në supe politike, non grata, është politike mbi të gjitha.

■ Koçi flet për masakrën Libofshës: Terror i pabesueshëm, njerëzit me lot në sy na drejtoheshin për të ndërhyrë

Rrëfimi tronditës i Petro Koçit për zgjedhjet e përgjakura të vitit 1994: Sali Berisha urdhëroi bandat të hidhnin vëzhguesin në lumë dhe të godisnin socialistët, ja kush është deputeti që për pak i prenë gishtat dhe si kriminelët kursyen vetëm Ilir Metën

Rigels SELIMAN

Deputeti i Partisë Socialiste, Petro Koçi ka kujtuar masakrën Libofshës 30 vite më parë duke treguar fytyrën e vërtetë të atyre që sot kërkojnë të krijojnë kaos, përplasje e rrëmujë më 11 korrik. Koçi, në reagimin e tij bën përgjegjës direkt Sali Berishën teksa kujton me detaje se si në ditën e zgjedhjeve, viti 1994, gjithçka u përgjak dhe njerëzit u masakruan. Sipas tij, Berisha urdhëroi bandat, të cilat rrahën deputetët e PS, madje Namik Dokles desh i prenë gishtat. Ai zbuloi detaje tronditëse edhe për rrëmbimin dhe masakrimin e vëzhguesit Luan Rustemi. Z.Koçi tha se atë e hodhën në breg të lumit Seman. Nga ana tjetër ai evidenton se bandat nuk prekën vetëm Ilir Metën. Këtu hidhen dyshime për pazaret mes tyre që kanë nisur që në ato vite. “Në ditën e zgjedhjeve nuk mbeti komisioner i PS pa u rrahur dhe përndjekur nga qendrat e votimit. Në fshatin Adriatik komisioneri i PD kishte vendosur koburen



që mbante si polic financiar mbi tavolinën e komisionit. Haptazi dhe me krenari kërcënonte kolegët komisionerë dhe çdo votues të PS që vinte për të votuar. Në fshatin Agim bandat rrëmbyen dhe masakruan vëzhguesin Luan Rustemi. Pasi e rrahën sa i ra të fikët, duke e konsideruar të vdekur, e hodhën në breg të lumit Seman. Fati desh që ai të shpëtonte nga disa fshatarë që kaluan andej. Bandat shpuan me thika gomate e makinave të PS. Një terror i pabesueshëm. Njerëz me lot në sy na drejtoheshin për të ndërhyrë. Kulmi ishte kur me një grup

deputetësh shkuam në qendrën e votimit ku ishte masakruar vëzhguesi Luan Rustemi. Bandat u mblodhën menjëherë dhe u vunë pas nesh. Në sy të policisë u goditën deputetët e PS-së Namik Dokle, Ndre Legisi, etj.. U përdoq me dhunë Shaqir Vukaj ish-nënkryetar i Kuvendit. U goditëm të gjithë. Policia bënte sehir. Deputetit Namik Dokle, për pak i prenë gishtat e dorës kur e futën me forcë në makinën e policisë duke ia mbyllur derën me egërsi. Vetëm Ilir Metën nuk e prekën. Njerëz shumë të mirë dhe me reputacion, që ne kishim

përzgjedhur si vëzhgues i keqtrajtuar në mënyrë barbare. Nënkrjetari i Komisionit Zgjedhor për Komunën e Libofshës, Sokrat Ikononi, u përdoq dhe u godit disa herë deri sa përfundoi në spital”, shprehet Koçi në rrjetet sociale.

A mund të shmangej kjo masakër?

Në përgjigjen e tij lidhur me pyetjen se a mund të shmangej kjo masakër dhe çfarë do ta bënte ndryshe nga këndvështrimi i sotëm, Koçi tha se në atë situatë i vetmi reagim ishte qëndresa. “Në atë situatë i vetmi reagim i yni ishte qëndresa. Rezistenca dhe gjakftohtësia. Nuk kishim asnjë mundësi të reagonim me mjete dhune dhe force. Ne bashkë me ata banorë aq të gatshëm e të sjellshëm, besimtarë tek demokracia, gjithçka e bëmë me zemër, me përkushtim dhe shpirt demokratik. Prandaj themi se ndaj Libofshës Partia Socialiste ka detyrime të përjetshme. Ne nuk ishim shteti, ishim opozita. Dhuna e Libofshës ishte dhunë e mirëfilltë shtetërore. Nuk ishte thjeshtë një manipulim i kamuff-

uar. Përkundrazi, ishte një përdhunë e urdhëruar nga “gjenerali” Sali Berisha dhe e ushtruar me krenari të turpshme, të pabesë dhe krejt zhburrërore”, tha ai.

Prapaskenat

Sipas Petro Koçit, skenarët dhe urdhrat vinin nga Sali Berisha. “Skenari dhe urdhri vinte nga zeusi i PD. A mund t’ju them diçka që të kuptoni çmendurinën e këtij mekanizmi me një shembull jashtë Libofshës? Por gjithnjë nën urdhrin e katilit Sali Berisha... Në zgjedhjet e 20 tetorit ‘96 në Patos, manipulimi ishte llogaritur dhe përqendruar nga militantët e PD-së, në disa qendra votimi. Rezultati i këtyre qendrave, jo vetëm nuk kishte shifra të krahasueshme me shumicën e qendrave simotra, por shkonte në 400 me 0, 350 me 0 në favor të... PD!?! Dhe ku? Në Patos, në rajonin me mbështetje historike për socialistët! Zbatuesit e skenarit ishin disa nëpunës të zyrave të shtetit, disa llogaritarë nga Ministria e Brendshme dhe ca ordinerë vendorë hyrë e dalë në burgje për vrasje e vjedhje...”, tha ai.

Endri Hasa: Kurrë nuk do jem pjesë e partisë personale të Berishës, struktura, ekipi dhe programi janë gati, do jemi alternativë në zgjedhje

Ish-deputeti i PD, Endri Hasa, pjesë e grupimit të demokratëve krahu Lulzim Bashës ka komentuar në një media situatën politike në vend, ndërsa thotë se janë një formacion politik i mirëstrukturuar, si në qendër dhe në bazë dhe se gjithë struktura partiake ekziston dhe është aty. “Kjo parti politike që ishte zyrtarisht dhe ajo që njihej nga gjykata deri më 11 qershor, gjithçka është

aty dhe nuk zhbëhen këto gjëra brenda natës dhe të bëhet një parti të re. Fakti që nuk ka një status politik, është e vërtetë, por nuk do të thotë që nuk ka parti politike. Partinë politike e bëjnë idetë dhe strukturat e organizuara. Teoritë me strukturat që po shkojnë te PD, atje, apo këtu, janë këta njerëz që nuk janë të vetëdijshëm se si është krisur ky grupim politik. Është një krisje

politike, në bazë të disa vlerave që ne si grupim, jemi ndarë. Një katastrofë ka ndodhur dhe këta njerëz janë përplasur me njeri tjetrin. Nëse individë të caktuar e gjejnë veten në kundërshtim me idetë që kishte deri dje, secili është në të drejtën e vetë që të bëjë zgjedhjen e tij. Kurrë nuk do të isha pjesë e një grupimi politik, ku bëjnë pjesë disa individë që janë përgjegjës për atë që ndodhi

më 8 janar, që është një turp për PD por dhe për Shqipërinë. Ne duhet të fokusohemi sot te beteja që kemi me shoqërinë. Ne kemi shprehur dëshirën që të bëjmë rekurs se besojmë se vendimi i vulës nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Por nga ana tjetër iu kemi thënë të gjithë shqiptarëve, që si strukturë politike, do të jemi në zgjedhje e ardhshme, qoftë kjo dhe me logo tjetër”,

deklaroi ai. Më tej Hasa deklaroi se nuk ka qenë në PD për shkak se besonte dikur te Sali Berisha apo te Lulzim Basha, por se është i djathtë. Në vijim shtoi se e kanë kundërshtuar sistemin aktual zgjedhor dhe se për votën e emigrantëve, mungon vullneti politik. Sa i takon mundësisë për drejtimin kolegjal Lulzim Bashës, Hasa tha se një gjë e tillë nuk i është kërkuar asnjëherë.

Zbardhen detajet nga dosjet

Ilir Meta dhe Ilir Beqaj dy politikanët më të rrezikuar në SPAK, dosjet e aferave drejt mbylljes, ish-ministri pritet të dënohet për “shpërdorim detyre”, ish-presidenti për “pastrim parash”

Elmas BOGDANI

SPAK-u nuk ndalon, po heton dhe merr përpara kushdo që i del se ka prekur buxhetin e shtetit. Kjo verë pritet të jetë e nxehtë jo vetëm nga temperaturat por edhe nga goditja e politikanëve që kanë futur duart në xhepat e taksapaguesve shqiptarë. Janë me qindra milionë euro në formë tenderimesh, koncensionesh, investitorë strategjikë, etj ku SPAK-u po bashkëpunon ngushtë me drejtorinë e pastrimit të parave, drejtorinë e Tatimeve, SHIK, Ministrinë e Brendshme, por më kryesorja edhe me autoritetet e huaja të cilat kanë sjellë të dhëna përvëluese për të fundosur VIP-at e korrupsionit. Këtë muaj, Prokuroria e Posaçme po përgatit dy goditje të bujshme. Ish-presidenti Ilir Meta dhe ish-ministri Ilir Beqaj janë më të rrezikuarit nga prangat e SPAK, pasi dosjet e aferave të tyre janë drejt mbylljes. Prokurorët po bëjnë modalitetet e fundit dhe dosjet pritet të shkojnë për gjykim.

Dënimi i Beqajit

Shfaqja e shpeshtë në intervista televizive të Ilir Metës, sulmet ndaj Altin Dumanit dhe amerikanëve të cilët i kanë bërë “gropën” me letër-porositë që kanë sjellë për



plotësimin e dosjeve, duken një simptomë e tundjes së prangave para syve që po i bën SPAK. Mbrojtja politike është rruga që ka zgjedhur Meta në përballjen me SPAK, ndryshe nga Ilir Beqaj, i cili është zhdukur nga qarkullimi duke u mbyllur në banesën e tij gjithë këtë kohë për të lexuar kutinë e mbushur plot me akte që mori nga SPAK më 31 maj. Ish ministri mori 700 fashikujt që SPAK ka vendosur në dosjen e sterilizimit për ta dorëzuar në GJKKO. Hetimet për koncesionin e sterilizimit u kryen nga prokurorët Edvin Kondili dhe Ened Nakuçi dhe dosja është në GJKKO e cila do të vendosë më 26

korrik nëse çështja do kalojë për gjykim apo do ta kthejë në SPAK për hetime të mëtejshme. Hetimet nuk mund të shtyhen më pasi kanë kaluar çdo afat të mundshëm. Ish-ministri pritet të dënohet për ‘shpërdorim detyre’ se ka miratuar kontratën koncensionare të sterilizimit në kundërshtim me ligjin. Hetimet 3-vjeçare kanë zbuluar shkelje të ligjit në procedurat e dhënies së njërit prej koncesioneve më të kushtueshme të sektorit të shëndetësisë, me qëllimin e vetëm të shpalljes fitues të kompanive të Ilir Rrapajt dhe shtetasit Italian, Umbro Staccini. Ilir Beqaj u zgjodh ministër i Shëndetësisë në kabinetin e parë

të kryeministrit Edi Rama dhe gjatë drejtimit të tij në vitet 2013-2017, u firmosën tre kontrata koncensionare prej dhjetëra milionë eurosh për shërbime të sistemit shëndetësor. Ndërkohë në shkurt u vendos sekuestro edhe ndaj dy kompanive të Rrapajt disa aksione të tij në një shoqëri tjetër tregtare, llogari bankare me vlerë 295 mijë euro, 13 makina e apartament në Vlorë.

Dënimi i Metës

Nga ana tjetër, Ilir Meta ka më shumë çështje të hapura me SPAK. Prokurorët pritet të firmosin shumë shpejt masë sigurie arrest me burg për Ilir Metën, për çështjen CEZ-DIA, dosjen e lobimit dhe shërbimet estetike. Dosjen CEZ-DIA, për shkak të presionit të madh politik, e ka marrë vetë në dorë prokurori i hekurt dhe i pakompromis, Altin Dumani, njeriu i besuar i amerikanëve për t'i dhënë fund tranzicionit dhe kulturës së mosndëshkimit në Shqipëri. Nëse vërtetohet se paratë e aferës CEZ-DIA kanë përfunduar tek LSI dhe xhepat e Ilir Metës, ky i fundit pritet të akuzohet për korrupsion dhe pastrim parash. Nga ana tjetër, prokurori Sotir Kllapi ka në duar dosjen e lobimit. Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Qipro ka ardhur përgjigja zyrtare për letër-porositë e SPAK-ut, ku konfirmohet se gjatë viteve 2016-2017, Ilir Meta ka shpenzuar qindra mijëra euro

“

Mbrojtja politike është rruga që ka zgjedhur Meta në përballjen me SPAK, ndryshe nga Ilir Beqaj, i cili është zhdukur nga qarkullimi duke u mbyllur në banesën e tij gjithë këtë kohë për të lexuar kutinë e mbushur plot me akte që mori nga SPAK më 31 maj. Ish ministri mori 700 fashikujt që SPAK ka vendosur në dosjen e sterilizimit për ta dorëzuar në GJKKO.

për lobim në SHBA, para këto që nuk u dihet burimi dhe që nuk janë deklaruar as në KQZ dhe as në ILDKPKI. Meta mund të akuzohet për pastrim parash dhe falsifikim formularësh. Arben Kraja ka në duar dosjen e shërbimeve estetike. Dhe aty dalin faktet se është bërë pastrim parash. Gjithashtu SPAK dyshohet se ka gjetur dhe pasuri të fshehura të Metës.

Berisha: Në 11 korrik, të ngrihem në një betejë kundër këtij regjimi që po boshatis Shqipërinë

■ Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha i ka bërë thirrje dje qytetarëve që mbledhen në protestën e 11 korrikut në Tiranë dhe të ngrihen kundër regjimit të Edi Ramës. “Miqte e mi, kanë kaluar 34 vjet nga ajo ditë dhe mësimi më i madh prej asaj dite është se para guximit të të rinjve shqiptarë nuk ka mur, nuk ka barrierë, nuk ka forcë në botë që mund të rezistojë. Ndaj dhe ajo ditë e kryengritjes paqësore të të rinjve të Tiranës, le të jetë një ditë frymëzimi për të rinjtë e sotëm dhe të gjithë shqiptarët, të ngrihem në një betejë kundër këtij regjimi, i cili në mënyrën më të pamëshirë, më antishqiptare po boshatis Shqipërinë. Po kryen gjenocid me largimin me kushte të llogaritura të shqiptarëve. Shqipëria sot

më shumë se kurrë ka nevojë të mbrohet nga bijtë dhe bijat e saj. Shqipëria sot më shumë se kurrë ka nevojë të kthehet shpresa në tokën e saj. Miqtë e mi, nga viti 2014 deri në vitin 2022, në 8 vite, sipas Eurostat, statistikave britanike dhe të SHBA, nga Shqipëria janë larguar 37.8 përqind e shqiptarëve. Në qoftë se i shtojmë kësaj shifre shqiptarët e larguar për në Lindjen e Mesme, Norvegji, Zvicër, Kanada, Australi dhe vende të tjera, ju garantoj se kjo shkon në 40 përqind. Kjo është boshatisje e tmerrshme e kombit. Ky është shkatërrim me shpejtësi të rrefeshme. Ndaj o sot o kurrë, t'i dalim zot këtij vendi. Me 11 korrik, të gjithë në Tiranë, ku jemi e nuk jemi, në betejë me narkoshtetin”, tha ai.

Juristi Çlirim Gjata: Simboli i korrupsionit në vend është Edi Rama

■ Anëtari i Këshillit Kombëtar të PD, Çlirim Gjata në fjalën e tij dje përpara protestuesve kundër arrestimit të liderit të PD, Sali Berisha është shprehur se sistemi shëndetësor pasqyron situatën korruptive që hasin qytetarët në të gjithë institucionet e vendit. “Sot për të disatën herë u shty procesi ndaj kreut të opozitës, Sali Berisha nga gjyqtarja me tre mbiemra, ose mbiemri me tre gjyqtare se çfarë thotë sot nuk e thotë nesër. Ne kemi një situatë të rëndë të krimit të organizuar dhe korrupsionit në këtë vend, disa ditë më parë zbulua një korrupsion tjetër të spitalit onkologjik dhe ato mjekë meritojnë dënimin më të rëndë për mjekët që bëjnë të tilla abuzimesh. Është një sistem i tërë shëndetësor i shkatërruar nga Rama. Të gjitha spitalet shtetërore kështu janë dhe ai shkon në takim me mjekët bërtet me zë të lartë dhe thotë që e luftova korrupsionin. SPAK është në hall se cilin duhet të arrestojë, Veliajn apo vëllain e Ramës i cili ka përgjime që nga Gjermani”, tha ai.

Spahiu: Shpallja 2.4 milion banorë, akt antishqiptar, largon investimet e huaja

■ Juristi Kreshnik Spahiu theksoi dje se zyrtarizimi nga Censi i 2.4 milion banorëve do të dëmtojë shumë ekonominë shqiptare. Kjo shifër sipas tij nuk do të josh më investimet e huaja, pasi është një kuotë nën shifrat e pranuar. Gjithashtu ai tregon edhe një bisedë që ka patur disa kohë më parë me shkrimtarin e ndjerë Ismail Kadare. “Tema e sotme lidhet me një ngjarje apo takim këshillimor që kam pasur disa kohë më parë me Ismail Kadare. Më dha një orientim shumë interesant thelbi i Censit, nëse Shqipëria del nën 2.4 milion banorë do dëmtojë interesa gjeo-politike të Shqipërisë. Ka një vijë të kuqe të konsideratave të fuqive të mëdha për disa shtete që bien nën një

minimum siç mund të jetë 2 milion. Zyrtarizimi i një shteti 2.4 milion banorë të nxjerrë tërësisht nga tregu ndërkombëtar. Kush kompani dhe korporatë mund të vijë në një shtet 2.4 milion banorë. Të gjitha këto korporata kanë kriter konsumatorin kush vjen në një treg kaq të vogël sa Shqipëria. Numri i vogël o popullsisë i deklaruar zyrtarisht e dëmton Shqipërinë. Italisë nuk i llogarisin edhe 40 milion italianë që jetojnë në diasporë. Edhe Greqia ka gjysmën e popullsisë jashtë por i merret për bazë ata që janë në vend. Me Kadaren kam biseduar kur kam kontestuar censin e parë. Më pati dhënë disa këshilla. Më tha që problematikat më të mëdha se etnia dhe feja”, tha Spahiu.

politikë

Hyseni hedh poshtë akuzat e Saliانji: S'jam shmangur, isha në Bruksel

Drejtoresha e SHISH dëshmon me dyer të mbyllura në Komisionin Hetimor për të dhënat e TIMS dhe hedh poshtë akuzat e opozitës, Saliانji përplasat me Ardi Veliun dhe kalojnë në ofendime, zbardhen debatet mes palëve

Mbledhja e djeshme e Komisionit Hetimor për të dhënat e sistemit TIMS u zhvillua me dyer të mbyllura, ndërsa raportoi drejtoresha e Shërbimit Informativ Shtetëror, SHISH, Vlora Hyseni. Vetëm me votat e socialistëve u miratua kërkesa e Hysenit për mbledhje të mbyllur me argumentin se informacionet përbëjnë sekret. Nga ana tjetër, opozita kërkoi mbledhje me dyer të hapura. Në nisje të mbledhjes palët u përfshinë nga një debat për shkak të mungesës së Hysenit në mbledhjen e kaluar të 26 qershorit, pasi ndodhej në Bruksel për takime në selinë qendrore të NATO-s. Vetë Hyseni u kujdes të sqarojë arsyet e mungesës, duke hedhur poshtë këtu deklaratat e kryetarit Ervin Saliانji se ndodhej në Beograd. "E kishim të pamundur paraqitjen në datë 26 për shkak të një angazhimi të detyrueshëm të konfirmuar muaj më parë, lidhej me dy arsye madhore, takimi me asistentin e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s për inteligjencën për të diskutuar për çështje të sigurisë rajonale dhe për të diskutuar për angazhimin e SHISH në kuadër të inteligjencës së NATO-s. Një angazhim tjetër ishte paraqitja e drejtorit të SHISH në samitin e NATO-s në Uashington që pritet të mbahet me 10 korrik. Në asnjë rast SHISH apo drejtori nuk i është shmangur raportimit para komisionit. Kërkoj që seanca të zhvillohet me dyer të mbyllura, duke pasur parasysh se flitet për problematika që lidhen me sigurinë kombëtare. Të mbrohen të dhënat e klasifikuara", deklaroi Hyseni.

Detajet

Më pas e mori fjalën Salinji, i cili kundërshtoi kërkesën e mazhorancës. Ju jeni sot këtu dhe s'kemi ç'të themi më shumë, përveçse se nga çfarë kemi parë nga dokumentacioni i deritanishëm që disponojmë në raport me çështjen, nuk shoh asnjë element që të përbëje sekret shtetëror. Duke pasur parasysh që kemi të bëjmë vetëm me aspekte procedurale dhe aspekte që janë zbuluar në publik, propozoj që mbledhja të bëhet e hapur, në çdo rast që ka informacion të klasifikuar drejtoresha mund të kërkojë mbledhje me dyer të mbyllura", tha Saliانji. Nga ana



tjetër, deputeti socialist, Xhemal Qefalia kërkoi nga Saliانji një ndjesë publike për akuzën që i bëri Hysenit, por ligjvënësi demokrat u përgjigj duke e 'këshilluar' që të mos bëjë mbrojtjen e SHISH. "Duhet ta fillosh mbledhjen me një ndjesë publike për kauzat që bëtë ndaj drejtueses së Shërbimit duke e ngatërruar qëllimisht vendin e saj të takimit, nga Brukseli në Beograd", tha Qefalia, të cilit iu përgjigj Saliانji. "Nuk i shkon formatit tënd që të bëhesh mbrojtës apo të bësh si punonjës i SHISH se nuk je tipikisht si punonjës i shërbimeve inteligjente", tha Saliانji. Edhe dëshmia e Florian Sulejmanit, Drejtor i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, me kërkesë të tij dhe me votat e socialistëve u zhvillua me dyer të mbyllura, ndërsa e njëjta kërkesë e ish-kreut të AMP Ardi Veliu ngjalli debate të forta. Shkak u bë objekti i kërkesës së depozituar nga Veliu, ndërsa tonet mes tij dhe Ervin Saliانji ashpërsuan deri në ofendime. "Ti je lesh I tërë në këtë rast. Ti je kokë e këmbë lesh. Nëse ti je analfabet nuk e kemi fajin ne. Përpara meje e këtij komisioni rri me qetësi, drejtoju e përgjigju", tha Saliانji.

Përplasjet

Kryetari i Komisionit hetimor të TIMS, Ervin Saliانji kaloi në përdorimin e gjuhës ofenduese në seancën ku ishte ftuar për të dëshmuar ish drejtori i AMP-se, Ardi Veliu. E gjitha nisi nga titulli i kërkesës depozituar në komision ku shkruhej "kërkesë për informacion".

Ardi Veliu: "Të dhënat janë sensitive, që kanë të bëjnë me të dhëna personale, aplikacione e sisteme të cilat në vlerësimin tim profesional është mirë të ruhet konfidencialiteti dhe të mos bëhen pjesë e opinionit publik. Mos bëj publikë do i shërbejë forcimit të sigurisë kombëtare"

Ervin Saliانji: "Pse problem është bërja publike apo vjedhja e të dhënave. Ku ka ngelur gjë pa dalë në këtë shteti. Keni shkruar kërkesë për informacion"

Ardi Veliu kërkoi të dëshmojë pa mediat pasi tha se kemi të bëjmë me të dhëna që është mirë të ruhet konfidencialiteti. Deputeti Qefalia i doli në krah Veliut duke i thënë Saliانji, se veprimet e tij ishin tendencioze. Kjo ka shkak-tua debat deri dhe në përdorimin e gjuhës ofenduese.

Pjesë nga debati

Xhemal Qefalia: "Po më duket tendencioze. Sepse kërkesa e sjellë nga një dëshmitar mban po të njëjtën lëndë. Zoti kryetar kjo është tendencioze"

Lefter Gështenja: Një përfaqësues i drejtorisë së policisë thotë 'kërkesë për informacion'. Duket që këto kërkesa realizohen në një kompjuter dhe nuk ndryshojnë titullin e lëndës

Ervin Saliانji: Pse ne e kemi fajin që s'dinë të shkruajnë drejtuesit e policisë?! Qenka bërë disa raste që qenkan të paaftë drejtuesit e policisë të hartojnë një shkresë dhe duan të luftojnë krimin?!

Ardi Veliu: Nuk kam ardhur të talleh as ti askush këtu.

Ervin Saliانji: Nuk e keni fjalën ju. Kur ta keni fjalën. Atëherë do të flasësh

Ardi Veliu flet pa mikrofoni

Ervin Saliانji: Zoti Qefalia do ta ketë ngaqë ka dyshim që dini të shkruani apo të lexoni. Me këtë gjuhë fol ndonjë vend tjetër. Bëjeni diku tjetër ku jeni mësuar. Kur e drejtoj unë komisionin nuk e bën dot.

Ardi Veliu flet pa mikrofoni

Ervin Saliانji: Ti je lesh i tërë në këtë rast. Ti je kokë e këmbë lesh. Nëse ti je analfabet nuk e kemi fajin ne. Përpara meje e këtij komisioni rri me qetësi, drejtoju e përgjigju.

Debate te TIMS, Qefalia-Saliانji: Kërkoj falje Hysenit, e akuzove se ishte në Beograd! Kryetari: Mos bëj mbrojtësin e SHISH, s'të shkon

Me debate u zhvillua dje nisja e mbledhjes së Komisionit për rrjedhjen e të dhënave të TIMS, ku dëshmon drejtuesja e SHISH, Vlora Hyseni. Deputeti socialist, Xhemal Qefalia i kërkoi Ervin Saliانji që t'i kërkojë falje Hysenit pasi e akuzoi qëllimisht sikur ishte në Beograd pasi mungoi në mbledhjen e kaluar, kur në fakt ajo ndodhej në Bruksel. Nga ana tjetër, kryetari i Komisionit Saliانji i tha që të mos bëjë mbrojtësin e SHISH pasi nuk i shkon.

Qefalia: Duhet ta fillosh mbledhjen me një ndjesë publike për kauzat që bëtë ndaj drejtueses së Shërbimit duke e ngatërruar qëllimisht vendin e saj të takimit, nga Brukseli në Beograd. Kërkoj ndjesë pasi është ndër institucionet kryesore që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare.

Lefter Gështenja: Nuk kuptoj pozicion që kanë mbajtur në institucionet shtetërore dhe keni lejuar që në TIMS, keni lejuar që të punësojnë njerëz në nivele të larta pa certifikata sigurie, vini këtu na thoni që janë të dhëna sensitive, ca të dhënash flasim, ndërkohë që me ligj kjo mazhorancë e ka përjashtuar sistemin TIMS nga përbërja sekret hetimor apo konfidenciale.

Toni Gogu: Privilegji s'duhet të na çojë në shkelje flagrante të ligjit, ligji thotë se në asnjë rast nuk lejohet që të fyejnë ose të prekin dinjitetin personal të personave të thirrur në komision. Të kthejmë urgjentisht këtë mbledhje në shinat e ligjshmërisë. Po bëjmë një gjë qesharake, ka ardhur dëshmitari me dy kërkesa, një me shkrim dhe një me gojë, kërkoi qartë zhvillimin e mbledhjes me dyer të mbyllura. Kryetari me ca xhonglime u mor me titullin e lëndës. I përpi kryetari kompetencat dhe thotë e vendos unë këtë, është apo nuk është. Më pas me votat e socialistëve u vendos që dëshmia e Veliut të mbahej me dyer të mbyllura.

Saliانji kundër mbledhjes me dyer të mbyllura: Si lakuriq

Saliانji: Në mbledhjen e kaluar kam pasur një shkresë nga SHISH për arsye që ka qenë në një aktivitet jashtë. Sot dëgjuam që ka qenë në Bruksel. Unë e pashë që ka qenë në Bruksel një ditë para se ishte në tëtter-in e atij që e kishte publikuar. S'dua ta kthej në këtë debat, se këtë pyetje për Beogradin apo elementë të tjerë që kanë të bëjnë me veprimtarinë e SHISH e kemi në Komision Sigurie, këtu kemi tjetër objekt. Po të doni e bëjmë se gati jam të bëj dhe atë debat në lidhje me Beogradin. Nuk i shkon formatit tënd që të bëhesh mbrojtës apo të bësh si punonjës i SHISH se nuk je tipikisht si punonjës i shërbimeve inteligjente. Si sekretar, jo Byroje, mund të jemi në rregull. Nuk të shkon të bësh mbrojtësi i SHISH, sot i kemi thirr si dëshmitar jo për të raportuar për veprimtarinë.

nate, mendoni se do ia hidhni, dëshmitarët vijën i hedhin 'topin' njëri-tjetrit

Kryetari i Komisionit të TIMS, Ervin Saliانji kërkoi që mbledhja ku do dëshmonte drejtuesja e SHISH të zhvillohej me dyer të hapura. Deputeti demokrat akuzoi mazhorancën duke i quajtur se po sillen si lakuriq nate, ndërsa tha se duke mbyllur mbledhjet mendojnë se do ia hedhin. Ndërkohë, sa u takon dëshmitarëve, Saliانji u shpreh se vijën në komision dhe ia hedhin topin njëri-tjetrit.

Saliانji: Jeni të axhituar sot.

Toni Gogu: Për të mos provokuar, ju lutem vijoni me hedhjen në votim të kërkesës.

Saliانji: Faleminderit që na qartëson dhe qetëson zoti nën kryetar. Kishte kërkesa për të diskutuar me kërkesën e SHISH. I shërben publikut dhe këtij institucioni që të jetë me dyer të hapura. Lakuriqi i natës nga drita verbohët dhe del vetëm në errësirë. Si lakuriq nate të heqim mediat, dritën të mbyllemi këtu dhe ju mendoni se do ja hedhim dot. Dëshmitarët vijën dhe ja kalojnë topin njëri-tjetrit. Kërkesa ime është që mbledhja të bëhet me dyer të hapura.

Belëri: Në qendër të çështjes sime janë interesat financiare të zhvillimit turistik

KQZ vihet në lëvizje pas kërkesës së PS, të enjten vendos për mandatin e Fredi Belerit si kryetar i Bashkisë së Himarës, ja hapat që do të ndiqen dhe kandidatët e mundshëm

Xhoana VRANIÇI

“O disaja” e Bashkisë së Himarës që nisi prej 12 majit të 2023 kur u prangos tekta blinte vota Fredi Beleri duket se brenda gushtit do të marrë fund. Pasi Apeli i Gjykatës së Posaçme (GJKKO) e shpalli fajtor kryebashkiakun e zgjedhur me vendim të formës së prerë, duke e dënua me 2 vite burg për blerje votash, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të shqyrtojë të enjten mandatin e tij. Kjo lëvizje e KQZ vjen pak ditë pasi kreu i FRESH në Himarë i dërgoi një letër kryekomisionerit Ilirjan Celibashi që të kërkojë shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit të Kryebashkiakut të zgjedhur të Himarës, Fredi Beleri si dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme. Ajo që pritet është shpallja e vakancës në bashkinë e Himarës, gjë që do të detyrojë Presidentin e Repub-



likës Bajram Begaj të shpallë datën e re të zgjedhjeve. Kreu i shtetit sipas Kodit Zgjedhor menjëherë pas njoftimit duhet të shpallë zgjedhjet e parakohshme jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga shpallja e vakancës. Kujtojmë se Fredi Beleri u arrestua në flagrancë

tekta bënte pazare për votat vetëm 2 ditë para zgjedhjeve vendore të 14 majit të 2023. Ai i fitoi zgjedhjet nga burgu me një diferencë të lehtë votash, më pak se 20 vota, por për shkak të arrestit nuk mundi të ulej asnjë ditë në karrigen e kryebashkiakut dhe as të bënte betimin.

“Pasi Apeli i Gjykatës së Posaçme (GJKKO) e shpalli fajtor kryebashkiakun e zgjedhur me vendim të formës së prerë, duke e dënua me 2 vite burg për blerje votash, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të shqyrtojë të enjten mandatin e tij...”

Mandatin vijoi ta mbante kryebashkiaku në detyrë Jorgo Goro deri më 23 mars, kur po ashtu u arrestua me urdhër të SPAK pas një kallëzimi që Fredi Beleri kishte bërë për të për pronat në Himarë. Më pas detyrën e drejtimit të bashkisë e mori përkohësisht Blerina Bala ndërsa aktualisht Himara drejtohet nga nënkryetari i Bashkisë Arqile Bollano.

Deklarata e Fredi Belerit për Associated Press

Sakaq kryetari i zgjedhur i Bashkisë së Himarës, Fredi Beleri ka dhënë një intervistë për agjencinë e lajmeve Associated Press, duke theksuar ndër të tjera se zgjedhja e tij si eurodeputet “do të ndihmojë në

vënien në qendër të vëmendjes mbi një problem madhor me të cilin përballet Shqipëria, që është shteti i së drejtës”. “Këtu, gjyqësori është krahu i gjatë i politikës,” shtoi ai. “Unë mendoj se këto probleme duhet të vihen në pah – mungesa e respektit për të drejtat e pakicës etnike greke, siç është e drejta e pronës ... dhe për t’u qeverisur nga njerëzit që ai zgjedh. Nuk kisha ndërmend të hyja në politikë në Greqi, ishte për shkak të nevojës për të nxjerrë në pah këtë problem të madh,” tha Beleri, i cili theksoi se “kushdo që më njeh e di me siguri se do të preferoja të isha kryetar bashkie. Beleri u shpreh se beson se në qendër të çështjes së tij janë “interesat e mëdha financiare për sa i përket zhvillimit turistik. Por është gjithashtu se kryeministri shqiptar nuk dëshiron që popullsia etnike greke të marrë pjesë në atë prosperitet,” u shpreh Beleri gjatë intervistës.

Komisioni Evropian njofton paketën e gjashtë të investimeve, cakton 1.2 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor

Komisioni Evropian njoftoi paketën e gjashtë të investimeve në kuadër të Planit të Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Bëhet fjalë për 1.2 miliardë euro për investime. KE-ja tha se kjo paketë do të mbështesë tetë

investime të reja kryesore në ujësjellësi dhe kanalizime, në trajtimin e ujërave të zeza dhe në transportin hekurudhor, si dhe në inovacionin në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Investimet do të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me

partnerë nga Ballkani Perëndimor dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Paketa e investimeve prej 1.2 miliardë euro përfshin 300 milionë euro grante të BE-së nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA III), kontribute shtesë dypalëshe nga

vendet anëtare të BE-së dhe nga Norvegjia, kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe kontribute nga ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Komisioni Evropian miratoi Planin e Investimit për Ballkanin Perëndimor në vitin

2020, i cili përfshin periudhën 2021-2027. Kjo paketë synon të nxisë rimëkëmbjen afatgjatë, të përshejtojë transformimin e gjelbër dhe digjital dhe të inkurajojë bashkëpunimin dhe konvergencën rajonale me BE-në.

Komiteti Parlamentar i Nismës së Evropës Qendrore, Hasani me tone të ashpra: Të përshpejtohet procesi i integritetit të Ballkanit, të mos ketë vonesa e rezerva

Ministri i Jashtëm Igli Hasani gjatë takimit në Komitetin Parlamentar të Nismës së Evropës Qendrore, u shpreh me tone të ashpra se nuk duhet të ketë më vonesa e rezerva procesi për integrimin e vendeve të Ballkanit perëndimor në BE, që sipas tij, duhet të përshpejtohet. Këto deklaratë Hasani i bëri në takimin e Komitetit Parlamentar të Nismës së Evropës Qendrore që u mbajt në Tiranë, organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë me temë: “Roli i parlamenteve në mbikëqyrjen e qeverive dhe procesit të integritetit evropian” “Të shtyrë edhe nga rreziku real i influencës së drejtpërdrejtë ose hibride të faktorëve të tretë në rajon, gjykojmë se është koha që vendet anëtare të Bashkimit Evropian t’i kushtojnë vëmendjen e duhur dhe të angazhohen pa vonesë e pa rezerva kundrejt përshpejtimit të integritetit të Ballkanit Perëndimor, por jo vetëm. I

shprehim mirënjohjen tonë Hungarisë, e cila, sot më 1 korrik, merr kryesinë e radhës së Bashkimit Evropian, duke përcaktuar si një prej prioriteteve të presidencës së saj zgjerimin e vonuar të vendeve të Ballkanit Perëndimor”, tha ai. Gjithashtu, kryediplomati shqiptar deklaroi se për Shqipërinë CEI- është një platformë pro aktive të bashkëpunimit rajonal, dhe se pala shqiptare ka mbështetur pa rezerva çdo propozim e projekt të kësaj nisme. Ndërsa zv. Kryetarja e Kuvendit Ermonela Felaj tha se shpreh se marrja nga Shqipëria e Presidencës së kësaj nisme është një mundësi që vendi ri konfirmojë vizionin, kontributin dhe përkushtimin për bashkëpunimin rajonal, paqen, sigurinë dhe rrugëtimin evropian të rajonit. Shqipëria është anëtare e Nismës për Evropën Qendrore prej vitit 1996 dhe ka presidencën e saj prej Janar 2024 – Dhjetor 2024.

Megaskandali i Onkologjikut, të enjten Kuvendi mban interpelancë me ministren e Shëndetësisë, Çuçi mbledh deputetët e PS-së

Të enjten e 4 korrikut Kuvendi i Shqipërisë pritet të mbajë interpelancën me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kërkuar nga një grup deputetësh të opozitës, grup deputetësh të opozitës lidhur me skandalin e Onkologjikut. Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste mbajti ditën e djeshme mbledhjen ku informoi deputetët për seancat që kanë mbetur deri në përfundim të këtij sesi. Ndërkohë, pritet të prezantohen edhe raporti vjetor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, raporti mbi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe raporti vjetor për veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në vijim pati diskutime të tjera për çështje të ndryshme të ngritura nga deputetët

e pranishëm në mbledhje. Kërkesat për interpelancë u bënë një ditë pasi u mësua se 7 mjekë dhe bashkëpunëtorë të spitalit të Onkologjikut janë në hetim për akuzën e shpërdorimit të detyrës pasi nuk i ofronin shërbim pacientëve duke i orientuar drejt privatit. Ndaj tyre gjykata e Tiranës dha masën e sigurisë ‘arrest shtëpie’ dhe detyrim me paraqitje. Interpelanca e parë është bërë nga kreu i Grupit parlamentar demokrat Gazment Bardhi i cili thotë se ministrja nuk mund të mjaftohet me dënimin e mjekëve por duhet të mbajë përgjegjësi. Sakaq, kërkesa e dytë për interpelancë u bë nga deputeti Arbi Agalliu që kërkon që ministrja të qartësojë menjëherë arsyet se pse nuk ka funksionuar sistemi i mbrojtjes së pacientëve dhe pse kjo skemë korruptive është e shtrirë në kohë.

politikë

■ A do ta fundosë pasuria Ballukun?

Ja si ka ndryshuar ndër vite pasuria e Belinda Ballukut, nga llogaritë bankare, apartamentet deri në Angli dhe 127 mijë euro nëpër duar që deklaronte, deri te “varfëria” që e ka kapur në vitet e fundit, tani jeton vetëm me pagën dhe honoraret si ministre

Në Shqipëri, mjafton që të shohësh stilin e politikaneve e oligarkëve me pasuritë e patundshme me vila në bregdet, si jetojnë, ku jetojnë dhe ku shkollohen fëmijët e tyre dhe del menjëherë në përfundime se 90 % e tyre është për burg. Gjithë këto vite, politika, institucione të kontrolluara prej saj dhe drejtësia e vjetër, kanë qenë bashkë duke shpëtuar pasuritë e tyre të paligjshme. Të gjithë kanë menduar se do t'ia hedhin paq, pasi kanë besuar se i kanë eliminuar të gjitha provat në aferat e tyre. Por është pasuria, elementi që pritet të fundosë politikanë e oligarkë. “Follow the Money”, kjo është skema amerikane që po ndjek SPAK, si udhërrëfyes në luftën kundër pasurisë së paligjshme. Ishte i njëjti model që fundosi ish-ministrin socialist Arben Ahmetaj. E njëjta skemë po përdoret për të shkatërruar plotësisht dhe familjen “Meta”-“Berisha”, ku bashkë me ta do të shkatërrohen gjithë bashkëpunëtorët e tyre për vendosjen e pasurive të pista. Në këtë situatë mund ta pësojë edhe Belinda Balluku, pasi me kallëzimet që i janë bërë “mal” në SPAK, nuk përjashtohet që prokurorët ta fusin në “filtër” për pasuritë e saj të dyshimta. Ngritja e Belinda Ballukut nga hiçi në funksionet më të larta drejtuese të



shtetit brenda një kohe relativisht të shkurtër, nuk iu ka shpëtuar as mediave të huaja, të cilat nuk e kanë fshehur habinë se si zv/kryeministrja Belinda Balluku dhe njëherazi ministre e Energjetikës e Infrastrukturës u gradua në këto funksione, edhe pse deri disa vite më parë punonte si ndihmës shtëpiake ose pastruese, në shtetin fqinj, Greqi.

Ja si ka ndryshuar ndër vite pasuria e Belinda Ballukut

Balluku u zgjodh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë në kabinetin e kryeministrit Edi Rama në janar 2019, pas largimit nga posti të Damian Gjijnurit. Më parë, ajo ka ushtruar detyrën e drejtoreshës së Përgjithshme të Albcontrol. Në vitet 2000-2004,

Balluku ka punuar në kompaninë e telekomunikacionit AMC, ndërsa në vitin 2004 iu bashkua stafit të Bashkisë së Tiranës, fillimisht si Këshilltare për Marrëdhëniet me Publikun dhe më vonë si drejtoresh e Kabinetit të kryebashkiakut Edi Rama. Balluku është angazhuar në Partinë Socialiste prej vitit 2006. Gazeta “SOT” po nxjerr disa detaje interesante nga pasuria e saj nga raportet e ILDKPI. Në deklaratën e parë të dorëzuar në ILDKPI në vitin 2013, Belinda Balluku deklaronte pasuri familjare me vlerë 128.6 milionë lekë, ndërsa në fund të vitit 2018, pasuria kap vlerën e 143.4 milionë lekëve, duke shënuar një rritje mesatare vjetore prej 2.4 milionë lekësh. Në fund të vitit 2018, Znj. Balluku

deklaronte pasuri të patundshme prej 61.6 milionë lekësh, likujditete bankare prej 54 milionë lekësh, pasuri të luajtshme prej 12.8 milionë lekësh dhe kursime në cash prej 14.9 milionë lekësh. Të ardhurat familjare për periudhën deklaruese janë 55.6 milionë lekë, nga të cilat rreth 66% burojnë nga paga e Znj. Balluku dhe 31% nga paga e familjarëve. Rreth 1.4% e totalit kanë si burim të ardhurat nga qiratë. BIRN disa kohë më parë identifikoi si “flamur të kuq” vlerat e larta të likujditeteve cash të mbajtura jashtë sistemit bankar nga Znj. Balluku. Në fund të vitit 2018, gjendja e deklaruar cash është 92 mijë euro dhe 1.5 milionë lekë, shumë herë më i lartë sesa kufiri i lejuar prej 1.5 milionë lekësh jashtë sistemit bankar për zyrtarët publikë. Vlen gjithashtu për t'u sqaruar se në analizën e pasurisë së Znj. Balluku janë përfshirë edhe pronat në bashkëpronësi si dhe depozitat dy-emërore me ish-bashkëshortin e saj, Sokol Balla. Pas vitit 2014, nuk deklarohen më të ardhurat e Z. Balla, por vetëm shtesa të likujditeteve në bankë të depozitave dy-emërore. Balluku deklaronte se është pronare me 50 % e një shtëpie në Angli, të cilën thotë se e ka blerë me kursime, me vlerë 95 000 paund. Ajo është pronare e vetme e një apartamenti në Tiranë me vlerë 37 922 euro, të cilin thotë se e ka blerë po me kursime. Ajo është pronare e vetme e një tjetër apartamenti me vlerë 97 500 euro. Këtë të fundit e ka blerë nga shitja e një apartamenti në Golem me vlerë 125 mijë euro.

Pasuria e Ballukut në vitin 2022

Pasuria e fundit e Ballukut e deklaruar në vitin 2022 në ILDKPI e nxjerr atë të varfër. Ajo ka deklaruar se të vetmin burim të ardhurash ka pagën dhe honoraret si ministre. Nuk ka deklaruar për vitin 2022 asnjë pronë apo automjet.

Llogari bankare

Detajet e ndryshimit: Pakësuar
Vlera: 50,398.00 ALL

Llogari bankare

Detajet e ndryshimit: Shtuar
Vlera: 2,890.00 EUR

Llogari bankare

Detajet e ndryshimit: Shtuar
Vlera: 487,851.00 ALL

Fonde investimi

Detajet e ndryshimit: Shtuar
Vlera: 78,239.95 ALL

Nga interesat bankare

Nga data: 01/01/2022

Në datë: 31/12/2022

Shuma Neto: 2,890.00 EUR

Honorare ose pagesa të tjera sipas kontratave të së drejtës civile

Emërtimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Honorare

Nga data: 01/01/2022

Në datë: 31/12/2022

Shuma Neto: 83,800.00 ALL

Emërtimi: Paga si Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Zv/Kryeministrit

Nga data: 01/01/2022

Në datë: 31/12/2022

Shuma Neto: 1,701,991.00 ALL

Karte krediti

Detajet e ndryshimit:

Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm: 634.00 EUR

Shuma e pashlyer: 920.00 EUR

Eliminohen një sërë tarifash për bizneset, ndryshojnë rregullat për shërbimet në QKB, çdo veprim kalon online

Bizneset do të kryejnë të gjitha shërbimet e nevojshme që marrin nga Qendrën Kombëtare të Biznesit, online Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në “Për regjistrimin e biznesit” i hedhur për konsultim publik synon të mundësojë shërbime vetëm online nëpërmjet portalit e-albania, duke shkurtuar kohë, procedura si dhe radhët e pritjes për qytetarët. Gjithashtu, me anë të këtij projektligji bëhen edhe disa ndryshime të tjera për sa i përket personave që lejohen të bëjnë aplikimin për regjistrimin fillestar të personave juridikë, formën e paraqitjes së dokumentave në aplikim, emërtimin e shoqërive tregtare, mënyrën e njoftimit të subjekteve për

miratimin, pezullimin dhe refuzimin e aplikimeve. Referuar dokumentit, konkretisht parashikohet që mënyra e ofrimit të shërbimeve për regjistrimin e biznesit dhe çdo ndryshimi tjetër, do të ushtrohet si funksion kryesor nga QKB nëpërmjet sportelit elektronik në platformën e-albania. Ndryshimet sjellin edhe eliminimin e një sërë tarifash për aplikim që paguheshin deri më tani nga biznesi, siç është tarifa për kryerjen e aplikimit për rezervimin e emrit si dhe është rregulluar mënyra e lëshimit të certifikatës për këtë qëllim. Po ashtu është hequr edhe tarifa për transferimin e emrit tek palët e treta, si dhe hiqet pagesa për kryerjen e aplikimit për kor-

rigjimin e gabimeve. Po ashtu, projektligji rregullon mënyrën e lëshimit të certifikatës së regjistrimit, e cila i shkon subjektit elektronikisht, njëkohësisht njoftimi i arsyes së refuzimit të aplikimit, i shkon subjektit në rrugë elektronike. Është sanksionuar fakti se certifikata e regjistrimit fillestar lëshohet vetëm një herë në momentin e miratimit të aplikimit, dhe i shkon subjektit në rrugë elektronike. Është rregulluar fakti se ekstraktet lëshohen vetëm në format elektronik dhe pa pagesë nëpërmjet sportelit elektronik si dhe ka ndryshuar emërtimi i shoqërive të bashkimit reciprok në përputhje me ligjin për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok.

3-mujori II, BSH: Bizneset rriten financat dhe normën e shfrytëzimit të kapaciteteve të tyre

Banka e Shqipërisë publikoi Treguesit e Ndjesisë Ekonomike (TNE), sipas të cilit “gjendja financiare e bizneseve dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve të tyre është rritur në tremujorin e dytë, në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2024”. “Në veçanti, në sektorët e industrisë dhe shërbimeve balanca e gjendjes financiare është zgjeruar me 7.7 pikë përqindjeje krahasuar me atë të një tremujori më parë. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve është rritur gjithashtu, në krahasim me tremujorin e parë, në të gjithë sektorët e biznesit. Rritja më e lartë ka rezultuar në sektorin e shërbimeve me rreth 3.1 pikë përqindjeje”, thekson BSH-ja. Sipas BSH-së, Treguesi i Ndjesisë Ekonomike qëndron 10.1 pikë përqindjeje mbi mesataren historike, ndonëse në qershor ra me 2.6 pikë. Rënia e TNE-së këtë muaj u ndikua kryesisht nga dobësimi i treguesve në sektorin e tregtisë, të shërbimeve dhe të ndërtimit. Në një masë më të vogël ndikoi edhe rënia e besimit në sektorin e industrisë dhe e besimit të konsumatorit.

■ Kujtim Hoxha tregon se kush përfiton rritje page

Ja si mund të bëhet shumë thjeshtë rritja e pensioneve të ulëta, lajme të mira edhe për sektorin privat, eksperti i njohur i ekonomisë Kujtim Hoxha jep informacionet e rëndësishme

Punonjësit e sektorit shtetëror nga 1 korriku kanë një pagë të re. Dy ditë më parë hyri në fuqi rritja për 135 mijë punonjës, që nga ushtria deri tek burgjet, arsimit dhe shëndetësia. Eksperti i njohur i ekonomisë, Kujtim Hoxha tek ka komentuar vendim, ka thënë se pagat e administratës shtetërore duhet të jenë të konkurrese me pagat e vendeve fqinje. Sipas tij, që të ndodhë një rritje e madhe e pensioneve, duhet që qeveria të shkurtojë numrin e punonjësve në administratë. Në intervistën për gazetën "SOT", Z. Hoxha tha se ky vendim është me benefite për të dyja palët, pasi ka një fryrje në administratë dhe në fund nuk ka as produktivitet. Po ashtu eksperti paralajmëron dhe rritje pagash në privat.



të jenë të konkurrese me pagat e vendeve fqinje. Kjo është një nga shkaqet kryesore të lëvizjes së trurit dhe të emigrimit të qytetarëve shqiptar drejt vendeve me paga më të larta. Me një politikë të tillë duke i ngushtuar pagat me vendet e Europës, njerëzit kanë tendencë të qëndrojnë në vendin e tyre. Kam një vërejtje me zbatimin e këtij vendimi të qeverisë, sepse është shkurtuar numri i qytetarëve shqiptar dhe në këtë këndvështrim nuk e di si qeveria mund të argumentojë duke mbajtur një administratë

të fryrë, janë 135 mijë punonjës shtetëror, janë jo produktiv pasi punojnë por nuk shtojnë rendimentin e produktivitetit. Ndërkohë kur teknologjia ecën përpara me e-Albania, paga vjen në rritje por sëpari duhet të bënin një pastrim në administratë duke e pastruar në 50% dhe më pas të rrisin pagat pasi nuk ka kuptim që të fryhet administrata dhe këto të ardhura që sigurohen në sektor jetik të vendit të paguanin pagat e administratës. Nëse do të ishte normale, 15% do ishte normalja në rajon ndërsa ne kemi 27% në raport me punonjësit që punojnë të siguruar brenda vendit, gati 800 mijë. Pra, 27% është e fryrë administrata shtetërore dhe është e pajustificueshme kjo shifër në raport me produktivitetin. Dhe % duhet të bie në nivelin e vendeve të Ballkanit Perëndimor e do të ishte e motivuar dhe e arsyetuar që administrata të marr një pagë më të lartë por me një numër të përgjysmuar punonjësish. Të gjitha të ardhurat që sigurohen në sektorë jetik të vendit, shkojnë direkte në shërbim të pagave të administratës. Ka një raport midis kategorisë shërbyese dhe asaj prodhuese, dhe administrata është në sektorin e shërbimit e si e tillë nuk mund të shtojë të ardhurash. Ka një problem pasi

në 10 vitet e fundit administrata është shtuar në 50 mijë punonjës, ku vetëm në sektorin e Policisë numri i efektivëve është rritur 15 herë më shumë krahasim me vitet e mëparshme.

-Cilat janë kategoritë që përfitojnë nga ky vendim për rritje page?

Rritjen e pagës e përfitojnë të gjithë ato të cilët pagat i kanë nën nivelin mesatar dhe ata që janë mesatar e duke u ngritur në nivel mbi mesatar. Është një politikë qeveritare e cila stimulon këto kategori duke i ndarë në grupe edhe në klasa, e duke marrë parasysh vjetërsinë e punës dhe pozicionin e punës së punonjës e si e tillë duke ndikuar në caktimin e masës për marrjen e më shumë apo më pak të pagës. Ndaj, merren një sërë faktorësh në pagën që merr një punonjës, qytetar i këtij vendi.

-A ndikon rritja e pagave të administratës në rritjen e pensioneve e sidomos atë minimal?

Këmbëngul gjithmonë që shteti në të mirë të tij do të ishte të shkurtonte numrin e punonjësve në administratën publike pasi nuk ka kuptim që paratë e grumbulluara t'ia jap administratës dhe më pas t'ua mbledh sërish kësaj kategorie e më pas t'ua shpërndajë pensionistëve. Kjo gjë është e pakuptimtë që i jep me dorën e majtë dhe ua merr me të djathtë por mund t'ua jepte direkte pensionistit dhe më pas mund t'ia kalonte direkte

pensionistit pa shtuar shpenzimet e tepërta të pa argumentuara në pagesë e qoftë në paga për administratën shtetërore. Të gjithë ato që paguhen në mënyrë të padrejtë për taksapaguesit pasi duket sikur mblidhen dhe më pas ua jep pensionistëve. Shteti i ka që përpara rritjes së politikave të pagave. Do të ishte në të mirë të saj shkurtrimi i vendeve të punës pasi këto të fundit shtyjnë njëri-tjetrin ku në një zyrë tani janë 4 veta me dy karrige, ku dy veta ulën për të punuar e dy veta konsiderohen si joproduktiv. Nuk kryhet shërbimi akoma dhe qytetarëve nuk iu ofrohet shërbimi i nevojshëm. Por, çdo punë që bëhet duhet arsyetuar e jo të qëndrojnë parazit.

-Kjo rritje e pagave në administratë a do të ndikojë edhe në sektorin privat?

Sigurisht që po, në fokus të qeverisë pas rritjes së pagave në sektorin publik, shteti çdo vit rrit në referim minimal vlerën për efekt të dredhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore. E si e tillë kjo gjë i bën të detyrueshëm që të gjithë të paguajnë sigurimet shoqërore jo më pak se pagën minimale. Çdo vit është parashikuar me ligj që të rishikohet dhe rivlerësohet dhe të ndikojë për rritjen duke sjellë rezultate kontribuuese. Edhe në privat nuk mundet të grumbullojë të ardhura për vitet e pensioneve pa rritur pagën minimale.

Intervistoi: Xhoana VRANIÇI

36.4% e çifteve nuk "guxojnë" të bëjnë fëmijë, mbi 60 mijë nëna mbajnë ngarkesën të vetme

Vështirësitë ekonomike, shtrenjtimi i kostove të jetesës, pasiguritë në punë, kanë bërë që afro 36.4 për qind e çifteve në Shqipëri të mos "guxojnë" të sjellin në jetë fëmijë. Të dhënat e Censit 2023, tregojnë se në total vendi ynë numëron 705 795 bërthama familjare, term që në statistikë tregon familje me lidhje gjaku mes tyre, nga të cilat 257 139 janë çifte të martuara, por pa fëmijë. Nga ana tjetër numërohen rreth 7743 çifte që bashkëjetojnë dhe nuk kanë fëmijë. Mesa duket edhe politika e bonusit të lindjeve, përmes së cilës familjet përfitojnë një shpërblim 40 mijë lekë për fëmijën e parë, 80 mijë lekë për fëmijën e dytë dhe 120 mijë lekë për fëmijën e tretë, nuk ka shërbyer mjaftueshëm si nxitje për çiftet e reja. Nëse do ta krahasojmë me vitin 2011,

numri i çifteve të martuara apo që bashkëjetojnë por që nuk kanë fëmijë është rritur me 69%. Referuar të dhënave të Censit, 363 131 janë çifte të martuara me fëmijë, apo 48.55%. Sa i takon numrit të fëmijëve që kanë, numrin më të lartë e përbëjnë çiftet me tre fëmijë, rreth 152 345 prej tyre, ndërsa 150 669 janë çifte me dy fëmijë. Ndërsa një numër më të vogël zënë çiftet me më shumë fëmijë, ku ata me mbi 5 janë vetëm 10 730 të tillë. Këto të dhëna nuk janë të specifikuar sipas moshës, për të bërë një ndarje midis çifteve të reja dhe atyre në moshë të madhe, por duke qenë se lindshmëria ka rënë ndjeshëm vitet e fundit, duket se çiftet me tre fëmijë e sipër janë ata që kanë një moshë të madhe. Nga ana tjetër janë edhe 5 327 çifte që bashkëjetojnë por që kanë fëmijë. Referuar të

dhënave, regjistrohet një shifër shumë e lartë e nënave të vetme me fëmijë, në 60 447, të cilat janë nëna të pamartuara, të divorcuara apo që kanë humbur bashkëshortin/partnerin. Ndërsa baballarë të vetëm numërohen 12 008 në të gjithë vendin. Gjithashtu të dhënat tregojnë se, deri në moshën 30 vjeç, përqindja e individëve beqar është më e lartë. Pas moshës 30 deri në 85 vjeç, rritet përqindja e personave të martuar, duke arritur pikun me rreth 88% në grupmoshën 45-64 vjeç. Pas moshës 65 vjeç e lart, përqindja e individëve të ve, ka një rritje të konsiderueshme. Në vitin 2020, Shqipëria kishte 6.16 martesat për një mijë banorë, pothuajse dyfishi i normës mesatare të Bashkimit Europian prej 3.2. Në Shqipëri, në vitin 2020 u regjistruan 1.5 divorce për një mijë banorë.

110 miliardë lekë të ardhura nga doganat në gjysmën e parë të vitit

Administrata doganore arkëtoi 110 miliardë lekë të ardhura në gjysmën e parë të këtij viti, me një rritje prej 7 miliardë lekësh, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. "Rritja e qëndrueshme e kërkesës për konsum, kryesisht për mallrat e akcizës, si karburante, cigare, kafe dhe pijet alkoolike, si dhe miradministrimi doganave, kanë sjellë 110 miliardë lekë të ardhura nga doganat për gjysmën e parë të vitit", bën të ditur Dogana. Sipas statistikave zyrtare, të ardhurat doganore (të ardhurat nga TVSH në import, akciza, taksat doganore dhe renta minerare) gjatë gjashtëmuajorit të parë

të vitit 2024 tejkaluan me 0.2% të ardhurat e planifikuara doganore për 6-mujorin e vitit 2024. Theksohet se tejkalimi i planit në gjysmën e parë të vitit është arritur pavarësisht efektit të madh të humbjes në të ardhurat doganore që vijon të shkaktojë rënia e kursit të këmbimit të euros e dollarit amerikan, që për këtë hark kohor përlllogaritet në 10.8 miliardë lekë. Efektin kryesor tek të ardhurat nga doganat e kanë dhënë të ardhurat nga akciza. Gjatë kësaj periudhe u zhdoguan 13 800 tonë karburant, 95 tonë cigare, 101 tonë kafe dhe 2900 tonë birrë më shumë.

aktualitet

16 deputetë të PD kërkesë prokurorisë së Përgjithshme për verifikim dekriminalizimi

Një tjetër zyrtar i PS rrezikon të digjet nga Dekriminalizimi, PD kërkesë Prokurorisë së Përgjithshme të verifikojë figurën e kryebashkiakut të Malësisë së Madhe Tonin Marinaj, ja akuzat nga anti-mafia italiane

Xhoana VRANIÇI



Zbardhen tre arsytet e Partisë Demokratike

1. Në datën 5 qershor 2015, Drejtoria Rajonale Antimafia, e Prokurorisë së Republikës, pranë Gjykatës së Firences, e përfaqësuar nga prokurori Dr. Giulio Monferini ka njoftuar mbylljen e hetimeve paraprake ndaj personave të hetuar, ku rezultojnë se shtetasi Tonin Marinaj, lindur në Shqipëri, më 05.12.1996, është në rolin e themeluesit, nxitësit dhe drejtuesit të një organizatë kriminale e përbërë prej më shumë se dhjetë anëtarësh, me tipare ndërshtetërore, me baza vepruese në Shqipëri dhe Itali, e angazhuar sistematikisht, profesionalisht dhe në vazhdimësi në eksportimin në territorin italian të sasive të mëdha të mariuanës për t'u shpërndarë me pakicë nga anëtarët e organizatës kriminale. Hetimet janë kryer në kuadër të procedimeve penale

nr. 1615/2010, nr. 14109/2010 dhe nr. 15892/2011 të Prokurorisë Antimafia në Firence.

2. Sipas informacioneve përshkruhen në detaje episodet e trafikimit të lëndës narkotike të llojit mariuanë, si dhe bashkëpunëtorët për kryerjen e këtij aktiviteti, përkatësisht: (i) Episodi i parë: Kreu i organizatës kriminale Tonin Marinaj ka organizuar dhe drejtuar importimin në territorin italian dhe shpërndarjen tek anëtarët të 50 kilogramëve mariuanë në Firence, në datën 29.05.2010; (ii) Episodi i dytë: Kreu i organizatës Tonin Marinaj ka organizuar dhe drejtuar importimin në territorin italian dhe shpërndarje tek anëtarët për shitje të jo më pak se 75 kilogramëve mariuanë, në Firence, në datën 14.06.2010; (iii) Episodi i tretë: Kreu i organizatës Tonin Marinaj ka organizuar dhe drejtuar importimin në territorin italian dhe shpërndarjen tek

anëtarët e 42 kilogramëve mariuanë, pjesë e një sasive prej 388 kilogramësh mariuanë të magazinuar në Firence, në datën 23.07.2010. Gjatë kontrollit të ushtruar nga Policia në këtë magazinë është gjendur edhe një pistoletë e kalibrit 9 mm dhe 100 gramë kokainë.

3. Në datën 29 mars 2016, prokurori Giulio Monferini ka depozituar në Gjykatën e Firences kërkesën për gjykim në kuadër të procedimit penal nr. 1615.10 RGNR mod.21 në ngarkim të disa shtetasve, përfshirë shtetasin Tonin Marinaj. Në përmbajtje të këtij akti janë parashtruar tre episodet e mësipërme, si dhe janë përshkruar provat mbi të cilat bazohet akuzat, të cilat kryesisht lidhen me përgjime telefonike në numrave dhe pajisjeve që kanë përdorur anëtarët e organizatës kriminale, e dyshuar si e drejtuar nga shtetasi Tonin Marinaj. Në datën 12 maj 2016, Zyra e Gjykatës për Hetime Paraprake, pranë Gjykatës së Firences, me gjyqtar Angelo Antonio Pezzuti pasi ka shqyrtuar kërkesën për gjykim dhe provat në ngarkim të të pandehurve, ku sërish relatohet se Tonin Marinaj është drejtuesi, organizuesi dhe nxitësi i organizatës kriminale të angazhuar në trafikimin e lëndës narkotike të llojit mariuanë, ka vendosur caktimin e seancës gjyqësore paraprake në dhomë këshillimi në datën 13 tetor 2016. Për këtë

Ja emrat që kërkojnë hetimin e kryebashkiakut të Malësisë së Madhe

1. Gazment Bardhi
2. Dhurata Çupi
3. Ina Zhupa
4. Zheni Gjergji
5. Ramadan Likaj
6. Sorina Koti
7. Albana Vokshi
8. Luan Baçi
9. Elda Hoti
10. Edmond Spaho
11. Emilja Koliqi
12. Flamur Hoxha
13. Oerd Bylykbashi
14. Agron Gjekmarkaj
15. Bledjon Nallbati
16. Asllan Dogjani

arsye, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka kërkuar fillimin e menjëhershëm të verifikimit të thelluar të të dhënave të deklaruarara në formularin e vetë deklarimit nga shtetasi Tonin Marinaj, me detyrë kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe referimin e gjetjeve përkatëse, për hetime të mëtejshme pranë Prokurorisë së Posaçëm Kundër Kriminimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), për nisje të hetimeve për dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së veprës penale të fshehjes së të dhënave në formularin e vetë deklarimit apo veprimtari të tjera kriminale.

KPA përfundon vetingun ndaj ish-prokurores së Kukësit, Fahrije Gjana u shkarkua pas problemeve me pasurinë

■ Kolegji i Posaçëm i Apelit ditën e djeshme ka përfunduar pa një vendim përfundimtar vetingun ndaj ish-prokurores së Kukësit, Fahrije Gjana. KPA shpalli dje vendimin lidhur me ankimin e kryer nga ish-prokuroerja e Kukësit, Fahrije Gjana Vata, kundër vendimarrjes së KPK që e shkarkoi nga detyra atë nga detyra më 28 janar të vitit 2022. Sakaq, kujtojmë se Gjana u shkarkua nga sistemi i drejtësisë për shkak të problemeve në kriterin e pasurisë. KPA në njoftim thotë se trupi gjyqësor i Kolegjit, i

kryesuar nga Mimoza Tasi, me relatores Albana Shtyllën dhe anëtarë Sokol Çomon, Ina Ramën e Natasha Mulajn, vendosi me shumicë votash të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar për Gjanën pa një vendim përfundimtar për çështjen, me argumentin se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur. Më 28 mars të këtij viti, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të moshës së pensionit të pleqërisë për prokurores e Kukësit, Fahrije Gjana Vata.

63-vjeçari nga Lezha tenton t'i japë fund jetës para SPAK, pasi përmbaruesit e mikrokredive i morën pasurinë

■ Në SPAK, mesditën e djeshme u rregjistrua një incident, ku qytetari Pal Trashaj, 63 vjeçari i cili njihet si historian në qytetin e Lezhës, dhe ka mbajtur dhe postin e PD-së në këtë qytet, 2007 - 2009, tentoi t'i japë fund jetës para godinës së Prokurorisë së Posaçme. Burime policore bëjnë me dije se 63 vjeçari dyshohet se ka konsumuar fostoksinë, ndërkohë sipas burimeve është paraqitur në QSUT me diagnozë intoksikimi. Mësohet se Pal Trashaj kërkonte takim për të zgjidhur problemin që ai kishte me kredinë në një institucion jo bankë të mikrokredive. Ai preten don se e ka shlyer borxhin por pas disa vitesh institucioni ka pretenduar se nuk e ka shlyer atë dhe dy përmbaruesit kanë marrë pronën.

KPA shkarkon gjyqtaren e Korçës Ariola Kristo pas mungesës së burimeve për ndërtimin e shtëpisë 3-katshe

■ Kolegji i Posaçëm i Apelit la ditën e djeshme në fuqi vendimin e KPK-së për shkarkimin e gjyqtares së Korçës, Ariola Kristo. Vendimi u mor në mënyrë unanime në dhomë këshillimi nga trupa gjyqësore e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, e përbërë nga Rezarta Schuetz kryesuese, Natasha Mulaj relatores, Albana Shtylla, Ina Rama, Sokol Çomo anëtarë pasi shqyrtuan ankesën e gjyqtares. Më 10 shtator 2021 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mori vendim për shkarkimin e gjyqtares Kristo për shkak

të problemeve me pasurinë. Problemet lidheshin kryesisht me mungesën e burimeve të ligjshme për ndërtimin e një shtëpie 3 kate plus bodrum në qytetin e Korçës në vitet 2006-2008, po kështu dhe një balancë negative fondesh në shumën 6.8 milionë lekë, për kryerjen e investimeve dhe përballimin e shpenzimeve. Ariola Kristo përfundoi studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2003 dhe u emërua gjyqtare në Gjykatën e Korçës. Ajo punoi prej gati dy dekadash pranë kësaj gjykate.

Lulzim Berisha del para gjykatës në Spanjë: Mos më ekstradoni në Shqipëri, më rrezikohet jeta

I arrestuar më 14 dhjetor të vitit të kaluar në Alicante të Spanjës, për vrasjen e Klodian Saliut në vitin 2005, i ndryshuar tërësisht në pamje, i shumëkërkuari Lulzim Berisha, i kërkoi Gjykatës Kombëtare spanjolle dje që të mos ekstradohet në Shqipëri pasi ka frikë për jetën dhe i druhet një hakmarrjeje të mundshme për shkak të krimeve të tij në të shkuarën. Kjo ishte përgjigjja e tij në seancën e ekstradimit, në të cilën prokuroria spanjolle ka kërkuar dorëzimin e tij drejt

Tiranës, ku të nis për të edhe gjykimi. Media Infobae shkruan se organi i Akuzës në Spanjë parashtrori dokumentet që autoritetet shqiptare kanë kopsitur për kërkesën për ekstradim, duke theksuar se i pandehuri në 2005-ën ishte përgjegjës për gjetjen e personave të përshtatshëm, për shkak të lidhjeve të tyre shoqërore dhe farefisnore, për të eliminuar fizikisht, Klodian Saliut, për çka ka pasur ndihmën e 3 personave që kryen vrasjen më 26 shkurt, duke lëvizur me

makinë. Më tej, organi i akuzës në Spanjë vijon duke treguar se Lulzim Berisha, pas planifikimit dhe organizimit të vrasjes, është larguar nga Shqipëria dhe është kthyer pak ditë pas ngjarjes. Më 27 shkurt 2005 në Tiranë u vra Vajdin Lamaj dhe një tjetër, në kabinën e ashensorit. Në realitet ky shpërthim ishte planifikuar nga Berisha dhe aktivizimi i eksplozivit është bërë përmes celularit. Në seancë, pasi e bëri të qartë se nuk dëshironte të ekstradohej, Lulzim Berisha

këmbënguli se frika e tij kryesore tani është jeta e tij pas kthimit në Shqipëri, sepse ka pësuar deri në katër sulme në të shkuarën. Sipas tij, shtëpia i është goditur me antitank dhe ka pësuar lëndime në trup. E ka përshkruar veten si sipërmarrës dhe është penduar që familja e tij duhej të ikte në Suedi nga frika e hakmarrjeve. Nga ana tjetër, ai ka treguar se mund të përfitojë pjesërisht nga një ligj amnistie i miratuar në vendin e tij, se prokuroria shqiptare ka kërkuar mbylljen e hetimeve në

lidhje me sulmin me bombë në ashensor dhe se ka kërkuar azil në Spanjë. Prokurorja e Gjykatës Kombëtare tha në seancë se Berisha ka dorëzuar një dokument sulmi të vitit 2015 kur ka qenë jashtë burgut, por nuk ka rrezik nëse ekstradohet pasi do të jetë në duart e shtetit shqiptar. Mbrojtja e Berishës kërkoi mos ekstradim të tij me të njëjtat argumente që i rrezikohet jeta. Në vijim Gjykata Kombëtare spanjolle pritet të jap vendimin mbi kërkesën e Shqipërisë për ekstradimin e tij.

■ SPAK po i heton zyrtarë në kuadër të dosjes "5D"

Prokuroria e Posaçme u komunikoi akuzat 3 zyrtarëve të Bashkisë së Tiranës, ja aferat ku janë përfshirë drejtorët e Erion Veliajt

Ish-kryebashkiaku i qytetit të Nju Jorkut, Rudy Giuliani, është përjashtuar nga detyra për pjesën e tij në përpjekjet për ndërhyrjen e zgjedhjeve të Donald Trump në 2020. Gjykata e Lartë e Nju Jorkut njoftoi vendimin të martën që ndalon Giuliani të ushtrojë profesionin e avokatit, i cili hyn në fuqi menjëherë. Giuliani më parë ishte pezulluar nga të qenit në gjendje të ushtronte profesionin e avokatit, ndërsa gjykata e Nju Jorkut shqyrtoi procedurat disiplinore të avokatëve kundër tij. “Serioziteti i sjelljes së keqe (të Giuliani) nuk mund të mbivlerësohet,” shkroi gjykata. “(Giuliani) keqpërdori në mënyrë flagrante pozicionin e tij të shquar si avokat personal i ish-presidentit Trump dhe fushatës së tij, përmes së cilës ai bëri deklaratatë të rreme, disa prej të cilave ishin të rreme, për gjykatën federale, ligjvënësit e shtetit, publikun, (Komiteti i Ankesave të Prokurorit), dhe kjo Gjykatë në lidhje me zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, në të cilat ai sulmoi pa bazë dhe minoi integritetin e procesit zgjedhor të këtij vendi.” Giuliani, tha gjykata, “jo vetëm që shkeli qëllimisht disa nga parimet më themelore të profesionit, por gjithashtu kontribuoi në mënyrë aktive në grindjet kombëtare.

Xhaka kritikon Italinë: Ishte shumë e dobët, e mundëm pa zbritur në fushë

Zvicra mposhti Italinë 2-0, për më tepër edhe duke dominuar me lojë. Të udhëhequr nga Granit Xhaka në rolin e kapitenit, Zvicra përgatitet për ndeshjen e çerekfinale ndaj Anglisë. Megjithatë, Xhaka në një intervistë të fundit i rikthehet edhe njëherë ndeshjes me italianët ndërsa thekson se ai kurrë nuk e kishte parë Italinë në një nivel kaq të dobët. “Unë urrej të humbasë, edhe në stërvitje nuk e pranoj humbjen. Unë dhe Akanji zhvilluam një sezon të madh, ashtu si edhe tre lojtarët që vijnë nga Bologna. Në përgjithësi të gjithë lojtarët kanë bërë mirë këtë sezon dhe ne jemi të “uritur” për

më shumë. Italinë nuk e kisha parë kurrë në këtë gjendje, ishte shumë në vështirësi. Mendoj se ne e fituam ndeshjen ende pa zbritur në fushë, kështu bënë edhe ata me ne para tre vitesh. Jam shumë krenar për atë që kemi treguar, jam krenar për çdo pjesëtar të skuadrës dhe stafit, sepse kjo që kemi arritur është shumë speciale. Jo vetëm për rezultatin, por edhe për performancën dhe lojën e shprehur. Kemi luajtur në nivel të shkëlqyeshëm dhe kemi qenë mentalisht shumë mirë, edhe pse përballë kishim një kundërshtar prestigjioz. E kishim në mendje atë disfatë 3-0 ndaj Italisë para tre vitesh. Por, këtë

herë treguam shumë shpirt skuadre dhe arritëm një objektivi që ishte mëse i merituar. Çdo fitore na shton më shumë besimin, ishim të disiplinuar taktikisht edhe me topin në zotërim, por edhe kur kundërshtari e kishte topin në kontroll”, u shpreh Xhaka. Ndërkohë, sipas një raporti, Granit Xhaka do të jetë i aftë për t’u përballur me Anglinë, pavarësisht se i është nënshtruar një skanimit për një dëmtim të mundshëm. Sipas “Blick”, ai do t’i nënshtrohet një skanimit MRI për shkak të disa problemeve, por “The Sun” raporton se ai do të jetë i aftë për t’u përballur me Anglinë pas rezultateve të testeve.



Sulmuesi dhe mbrojtësi pritet të ndryshojnë skuadër brenda merkatos së kësaj vere

Broja në “radarët” e Evertonit, Çelsi i vë çmim final 25 mln paund, Ismajli drejt Beshiktashit turk

Adriatik BALLA

Lojtarët e Kombëtares janë kthyer pranë skuadrave të tyre europiane pasi mbyllën aventurën në Europeanin e Gjermanisë. Një pjesë vijojnë të shijojnë pushimet pasi i kanë kontratat afatgjata me klubet dhe në këtë kuadër ndihen të qetë e të sigurt, por ka të tjerë që po negociojnë bashkë me agjentët e tyre për të ndryshuar destinacion dhe për të kaluar në klube ku të mund të rrisin kreditet e karrierës së tyre. Dy lojtarët që janë në fokus më shumë nga të tjerët janë Armando Broja dhe Jasir Asani, por dyshes së lartpërmendur i është shtuar së fundmi edhe emri i mbrojtësit Ardijan Ismajli. Referuar mediave, mbrojtësi kuqezi kërkohet me forcë nga Beshiktashi turk dhe mund të ketë surpriza në këtë merkato, kurse sulmuesi Broja kërkohet nga Evertoni. Çelsi, klubi që ka kartonin, është gati ta shesë për 25 milionë paund, mjafton që të sigurojë në treg elementët që i ka piketuar që më parë. Situata për të gjithë lojtarët që duan të lëvizin në treg duket premtuese dhe në rrugën e duhur.

Ismajli drejt Beshiktashit turk
“E ardhmja e Ardijan Ismajlit mund të jetë në Turqi”,



shkruajnë mediat sportive. Beshiktash është skuadra që synon të transferojë mbrojtësin shqiptar, me mediet italiane që raportojnë se drejtuesit e klubit turk që do të takohen shumë shpejtë me Empolin për të nisur negociatat. 27-vjeçari vjen pas një sezoni të mirë në aspektin personal, me Ismajlin që zhvilloi 27 ndeshje me Empolin, por duhet theksuar se në kampionatin e fundit mbrojtësi “kuqezi” kaloi edhe një periudhë dëmtimi. Sipas burimeve, Beshiktash, klub në të cilin luajnë edhe Ernest Muçi dhe Milot Rashica, është i vendosur për të mbyllur me sukses këtë operacion, për të përforcua repartin e mbrojtjes,

një kërkesë e trajnerit holandez Xhiovani Van Bronkhorst. Ismajli ka kontratë me Empolin deri në verën e vitit 2025 dhe në një situatë të tillë klubi toskan do të shqyrtojë çdo ofertë në drejtim të mbrojtësit që ishte gjithashtu i grumbulluar me Shqipërinë në EURO2024, por që nuk luajti asnjë minutë. Tani pritet me shumë interes për të parë se çfarë do të ndodh dhe nëse Beshiktash do t’ia dalë të transferojë Ardian Ismajlin.

Broja drejt Evertonit, Çelsi i vë çmim 25 mln paund

Sulmuesi kuqezi me gjasë do të largohet nga Çelsi në këtë merkato vere. Blutë e Londrës e kanë futbollistin në listën e lojtarëve që do të lënë skuadrën,

“Referuar mediave mbrojtësi kuqezi kërkohet me forcë nga Beshiktashi turk dhe mund të ketë surpriza në këtë merkato, kurse sulmuesi Broja kërkohet nga Evertoni dhe Çelsi, klubi që ka kartonin, është gati ta shesë për 25 milionë paund...”

gjatë këtij seksioni merkatoje. Sipas një raporti të fundit nga “The Guardian”, Çelsi shpreson të arkëtojë 25 milionë paund nga shitja e Brojes. Në fakt, interesim serioz ka nga skuadra e Everton, klub i cili është gati të paguajë shifrën e përmendur. Për yllin kuqezi kalimi te Evertoni do të ishte një mundësi për të treguar veten, duke marrë parasysh faktin se ai do të kishte në dispozicion minutazhin e duhur. Broja, pas “shtegtimit” të fundit te Fullhemi që nuk rezultoi e suksesshme, kërkon të nisë edhe një herë nga e para, me shpresën se gjithçka do të shkojë mirë. 22-vjeçari u aktivizua me Shqipërinë në European. Ai luajti 77 minuta me Italinë dhe 33 minuta me Spanjën, ndërsa ndaj Kroacisë qëndroi në pankinë.

MESFUSHORI

Keidi Bare drejt Malagës, e konfirmojnë mediat spanjolle

Mediat spanjolle kanë mësuar se së fundmi Keidi Bare ka marrë një ofertë me të vërtetë tunduese. Bare duket se është i interesuar për t’u kthyer te ish-skuadra e tij, Malaga, e cila sapo është ngjitur këtë vit përsëri në kategorinë e dytë spanjolle. Klubi kërkon të përforcimet me lojtarë cilësorë që të bëhet edhe një herë një ekip që pretendon ngjitjen në elitë. Bare shihet si një përforcim i rëndësishëm për këtë ekip ku ai ka luajtur dy vite, para se të transferohej te Espanjoli.

KOMBËTARJA

Një gjeneratë e re po dominon ngjyrat kuqezi

Armando Broja, Ernest Muçi, Arbër Hoxha, Mario Mitaj, Medon Berisha, Kristian Asllani dhe Nedim Bajrami. Një gjeneratë e re futbollistësh që garanton të ardhmen e Kombëtares shqiptare, edhe pse ka edhe shumë lojtarë të tjerë me potencial që mund t’iu bashkohen emrave më sipër. Kushdo trajner që do të jetë, diçka e ka të sigurt: një brez lojtarësh të cilët premtojnë shumë dhe mund të japin garanci për të arritur gjëra të mëdha me ekipin kombëtar në ardhmen e afërt. Këta janë brez i shkëlqyer kuqezi.

MERKATO

Berisha dhe Dermaku në kërkim të një skuadre të re


Emri i portierit Etrit Berisha ka dalë në listën e atyre që po kërkohen nga Sampdoria e cila luan në Serinë B. Ata kërkohen rikthimin në Serinë A dhe trajneri Andrea Pirlo do të dëshironte të kishte në skuadër portierin kuqezi. Kurse për mbrojtësin Kastriot Dermaku kanë qenë dy vite të vështira për shkak të dëmtimeve të njëpasnjëshme. Herën e fundit që ai ka luajtur ka qenë më 6 gusht të 2023 në ndeshje miqësore me Kadizin ku luajti 5 minuta. Edhe për lojtarin mbrojtës ka interesime.

Situata/ Daku nuk ka frikë të kthehet tek Rubin Kazani, flet babai i lojtarit

Europiani për Shqipërinë u mbyll me vetëm ndeshjet në grup, pasi u eliminuam, por jehona e kuqezinjve vijon të jetë e fortë. Mediat ruse vazhdojnë t’i kushtojnë rëndësi të ardhmes së sulmuesit Mirlind Daku te Rubin Kazani, pas skandalit që reprezentuesi i Shqipërisë e shkaktoi në Euro 2024. Daku u dënua me dy ndeshje moslojë nga UEFA pasi me altoparlant nisi

një këngë fyese ndaj serbëve e maqedonasve. Rubin Kazani ka paralajmëruar dënimin e Dakut, që në një intervistë të gjatë për një medium rus kërkoi falje dhe shprehur keqardhje për rastin e ndodhur pas ndeshjes me Kroacinë. Por, a po frikësohet Daku të kthehet në Rusi? Për këtë ka folur babai i futbollistit, Fehmiu, për “sport24.ru”. “Për katër apo pesë ditë djali im

do të arrijë në lokacionin e Rubinit. Mirlindi nuk frikësohet të kthehet në Rusi. Ai ka kuptuar që ka bërë gabim. Pres që edicioni i ardhshëm të jetë më i miri në karrierën e djalit tim”, ka thënë Fehmi Daku. Sipas mediave ruse, Rubin Kazani i ka përfituar 174 mijë euro nga UEFA për paraqitjen e Dakut në Evropian. Shifër të njëjtë ka përfituar edhe Lokomotiva e



Moskës për paraqitjen e Mario Mitajt. Gjithsej katër lojtarë të kampionatit rus ishin pjesë e Evropianit.

kulturë

Shfaqjet "Gruaja e thyer", "Mbretëreshat e klubit të natës" dhe "Mein Kampf" në skena

Shfaqjet e Teatrit Eksperimental përgjatë korrikut në Tiranë dhe në qytete të tjera

Nga Julia VRAPI

Shfaqjet "Gruaja e thyer", "Mbretëreshat e klubit të natës" dhe "Mein Kampf" përgjatë muajit korrik do të jenë në skenat teatrore. Produksione teatrore të Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" në Tiranë, si dhe një shfaqje në bashkëpunim, do të jenë për publikun jo vetëm në skenë të tjera. Shfaqja "Gruaja e thyer" që vjen me regji nga Endri Çela dhe interpretimin e aktorese Adriana Tolka do të jetë këtë mbrëmje për publikun tek "Mësonjëtorja e parë shqipe" në qytetin e Korçës, si dhe më datë 8 korrik në qendrën "Arka" në qytetin e Shkodrës. Në vijim do të jetë në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" te "ArTurbina" shfaqja "Mbretëreshat e klubit të natës" që do të shfaqet mbrëmjen e 16 korrikut. Nga 'Bruch' dhe Klaudja Piroli. Me Rexhina Ibro, Matia Llupa, Paolo Kadillari, Ina Kollçaku. Kontribuan Kunthug, Valentin Mase. Pas këtyre shfaqjeve në vijim do të jetë për publikun po në skenë të "ArTurbina" shfaqja "Mein Kampf" me regji nga Altin Basha dhe aktor Florian Agalliu. Kostimografe dhe skenografia Iliriana Basha, koreografia Silvester Shuta, përkthye Rovena Vyshka. Kjo shfaqje që vjen si bashkëpunim me teatrin do të jetë në skenë për publikun te "ArTurbina" në datat 25 dhe 26 korrik.

Monodrama "Gruaja e thyer"

Monodrama "Gruaja e thyer" që shfaqet këtë mbrëmje në Korçë dhe në vijim në Shkodër, më parë shënoi premierën në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli". Shkruar nga Simone De Beauvoir, interpretimin e aktorese së njohur Adriana Tolka dhe regji nga Endri Çela, një monodramë e kohës, që trajton boshllëkun njerëzor, vetminë dhe

TEATRI KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI" PROGRAMI 2024

KORRIK 20:30

MËSONJËTORJA E PARË SHQIPE, KORÇE

QËNDRA ARKA, SHKODËR

"GRUAJA E THYER"

REGJIA: ENDRI ÇELA

INTERPRETON: ADRIANA TOLKA



Muriel 43 vjeçe, pas pesë vitesh që jeton e vetme dhe e mbyllur në apartamentin e saj, mezi pret të nesërmen për t'u takuar me bashkëshortin dhe të birin e mitur, që jeton me të atin. Ajo ka planifikuar të shtrojë gjithë arsyet se përse i biri duhet të jetojë me të ëmën...


krizën e individit në marrëdhënie me shoqërinë ku jeton. Një shfaqje kontemporane, ku gjithçka buron nga e brendshmeja e personazhit: lëvizja trupore, fjala, imazhi, muzikaliteti, e kënduara dhe e luajtura e muzikës "live". Shfaqja është e përshtatshme për një publik mbi 16-vjeç. Shqipëroi Amantia Kapo, skenografia Beqo Nanaj, kostumografia Sofi Kara. Muzika nga Adriana Tolka dhe në violonçel Sotiraj Jorgji. Muriel 43 vjeçe, pas pesë vitesh që jeton e vetme dhe e mbyllur në apartamentin e saj, mezi pret të nesërmen për tu takuar me bashkëshortin dhe të birin e mitur, që jeton me të atin. Ajo ka planifikuar të shtrojë gjithë arsyet se përse i biri duhet të jetojë me të ëmën. Mirëpo, gjatë natës, duke

kaluar nëpër kalvarin e kujtimeve, ajo zbërthen, sipas këndvështrimit të saj - të një njeriu perfeksionist - marrëdhëniet e ngushta familjare e shoqërore dhe nuk rresht së fajësuarit të tjerët: dy bashkëshortët për dështimin e martesave të saj, të bijën për vetëvrasjen që ka kryer, të ëmën, e cila e ka përbuzur gjithmonë, të vëllanë, shoqet e ngushta e deri tek fqinjët. Nga ana tjetër, justifikon qëndrimet e saj, duke e paraqitur veten të sinqertë dhe gjithmonë në kërkim të rregullit dhe të një familjeje tradicionale, ku një grua duhet të ketë me patjetër një burrë në krahë dhe fëmijë për t'u kujdesur, që të fitojë një status të denjë për moralin e shoqërisë. Në këto kushte, ajo pret ditën e nesërme, e cila nuk i dihet se ç'të ardhme do i sjellë.

Mozaiku i Bazilikës Paleokristiane, një nga mozaikët më të bukur të vendit tonë

Mozaiku i ambientit qendror të Bazilikës Paleokristiane extra-muros në Elbasan është një nga mozaikët më të bukur të vendit tonë. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore shprehet se i datuar në shekullin V-VI, ky mozaik i realizuar me një teknikë të lartë, përmban motive gjeometrike, zoomorfe dhe njerëzore. "Ky mozaik qëndroi i hapur për vizitorët në

kuadër të "Javës së Mozaikëve", iniciativë e IKTK në bashkëpunim me DRTK-Korçë. Mozaiku dhe fragmentet e pikturës murale në muret e bazilikës, mbeten në fokusin e punës së IKTK", thuhet nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. E njohur si Bazilika Paleokristiane extra-muros në Elbasan, në të janë gjetur shtresa të një mozaiku në sipërfaqen e godinës dhe fragmente mozaiku parietal



(mural). Ajo është e pozicionuar fare pranë qendrës së qytetit të Elbasanit dhe është një ndër monumentet më me vlerë të qytetit. Zbulimi i mozaikut u bë i mundur në gjysmën e parë të vitit 2007, gjatë gërmimeve të kryera në këtë bazilikë në një thellësi rreth 3 metra. Mozaiku ka një sipërfaqe prej 25 metrash katrorë, që gjendet në qendër të qytetit të Elbasanit, pranë një tjetër monumenti, siç është Rrapi i Bezistanit. Mozaiku, përveç dy figurave njerëzore, në përbërje të tij ka edhe elementë të tjerë të cilët përmbajnë skemën e përjetësisë. Poshtë këtij mozaiku fshihet një bazilikë e shekullin V, që përbëhet nga shumë elementë arkitektonikë, mes të cilëve vlen të veçohet mozaiku dhe afresket. Bazilika Paleokristiane e Elbasanit është monument kulture i kategorisë së parë.

MHK kujton 2 korrikun e vitit 1990

Muzeu Historik Kombëtar kujtoi 2 korrikun 1990. MHK shkruan se në 2 korrik të vitit 1990, mijëra shqiptarë hynë në territorin e ambasadave të huaja që funksiononin në atë kohë në Shqipëri në kërkim të lirisë së munguar prej 5 dekadash. "Brenda pak ditëve në oborret e ambasadave të Gjermanisë, Francës, Italisë e të Greqisë, kishin ngritur "kampin e fushimit" rreth 5.000 refugjatë shqiptarë që

kërkonin azil politik. Edhe pse nuk e dinin se ku do të përfundonin, shqiptarët kapërcyen muret e selive diplomatike në Shqipëri me një qëllim të vetëm: ikjen për në perëndim. Kjo ngjarje është konsideruar si rënia e "Murit të Berlinit" në Tiranë, që më pas do të sillte dhe zhvillime të tjera për të kulmuar në dhjetor të vitit 1990 me lëvizjen studentore dhe lejimin e pluralizmit politik", thuhet nga MHK.

Kalaja objekti kryesor turistik në qytetin e Shkodrës

Kalaja e Shkodrës përbën një simbol të qytetit, e pranishme ndër piktura, gdhendje, etj. Kalaja është një prej kështjellave më të rëndësishme të Shqipërisë dhe objekti kryesor turistik në qytetin e Shkodrës. Drejtorja Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër ndau në faqen e saj pamje të kalasë së Shkodrës: "Dielli përflakët në kalanë e Shkodrës, ndërsa rrezet e tij të arta e të ngrohta zbresin mureve të vjetra

prej guri, duke shkëlqyer në çdo detaj arkitektonik, për t'ia lanë vendin hanës të bjerë ngadalë mbi horizontin e thellë, duke krijuar një peizazh të mahnitshëm ku ngjyrat portokalli përplasen hije rëndë në qytetërimin e lashtë", thuhet nga DRTK Shkodër. Kalaja e Shkodrës që mban emrin Rozafa është një monument mijëvjeçar i ngritur mbi një kodër shkëmbore në hyrje të qytetit të Shkodrës, në jug-lindje të tij.

Muzeu "Shtëpia me gjethe" përkujton aktorin dhe dramaturgun Kujtim Spahivogli


Muzeu "Shtëpia me gjethe" përkujtoi aktorin dhe dramaturgun Kujtim Spahivogli (30 qershor 1932-7 korrik 1987). Kujtim Spahivogli lindi më 30 qershor të vitit 1932 në Lushnjë. Studimet e larta për teatër i kreu në Moskë në vitin 1956. Ishte një ndër studentët e shkëlqyer të ardhur nga Bashkimi Sovjetik dhe në vitin 1956 u emërua aktor në Teatrin Popullor. Roli i tij i parë në skenën e Teatrit

Popullor ishte Xherxhinski në dramën "Orët e Kremlinit", dhe më pas luajti një sërë rolesh në dramën "Majlinda", "Në anën tjetër", "Dragoi i Dragobisë", "Hamleti", etj. Por më shumë u shqua si regjisor në Teatrin Popullor dhe si pedagog në Institutin e Lartë të Arteve. Ka vënë në skenë pjesët: "I Çuditshmi", "Gratë gazmore të Windsorit", "Në tufan", "Shtëpia në bulevard", "Drita", "Karnavalet e Korçës", "Qielli i kuq", etj.

Studiuuesi thotë se në QKLL kanë aplikuar autorë që vinin nga letërsia për fëmijë, por dhe për të rritur

Xhahid Bushati: Kemi mangësi në prurjen e një letërsie të mirë, siç e kërkon koha, realiteti dhe fantazia e fëmijëve

Nga Julia VRAPI



Si studiues dhe krijues i kësaj letërsie, i ndjekjes së saj në vazhdimësi; nga një shikim formal, veprat që ishin më thonin se akoma kemi mangësi në prurjen e një letërsie të mirë, siç e kërkon koha, realiteti e fantazia e fëmijëve dhe stadi i tyre kulturor...

kishte një vepër), pashë dhe autorë që nuk i njihja, autorë që i janë përkushtuar kësaj letërsie dhe, tek këto të fundit dua të ndalem. Duke lexuar krijimtarinë e mëparshme të tyre më rritën më tej besimin për një shpresë të kësaj letërsie që kërkon përkujdesje më të thelluar, por pashë edhe ndonjë autore që krijimtaria e saj nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë letërsi, por më shumë me "stërvitjen" psikoanalitike të fëmijëve, pashë edhe disa problematika të tjera që duhen diskutuar dhe koha do të jetë dëshmitare", thotë studiuesi Bushati.

Një njohës i letërsisë

Xhahid Bushati shkruan prozë dhe poezi, pjesë për kukulla, merret me publicistikë e studime të letërsisë për të rritur e fëmijë, etj. Si një njohës i mirë i letërsisë për fëmijë Bushati jep mendimin e tij për disa prej autorëve që janë

sot me këtë krijimtari. "Si njohës i kësaj letërsie me libra të botuar, shkrime, ese e opinione, shënime të herëpashershme të problematikave të ndryshme në rrugëtimin tim misionar dhe fisnik, më jepet e drejta të mendoj, duke njohur arritjet e autorëve në fushën e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, sipas meje paraqesin interes, vlera e pse jo tipologji të reja autorët: Fatmir Gjestila, Loer Kume e Rovena Rozhani. Kam besim në talentin e këtyre krijuesve. Pastaj, juria e nderuar ka detyrën e gjykimit, për të cilën do ta respektojmë", shprehet shkrimtari. Nëpërmjet Fondit të Krijimtarisë Letrare për Fëmijë për vitin 2024, QKLL-ja synon të mbështesë autorët shqiptarë të letërsisë për fëmijë dhe do të vijojë të jetë ndër projektet e saj bazë dhe të përvitshme.

Akademia e të Rinjve një tur prezantues të vizionit, objektivave dhe të veprimtarisë

Akademia e të Rinjve ka nisur nga Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës, një tur prezantues të vizionit, objektivave dhe të veprimtarisë së saj, në Institucione të Arsimit të Lartë, fakultete dhe institute kërkimore. Akademia shprehet se ky tur ka si qëllim njohjen dhe rrjetëzimin e kërkuesve e rinj kudo ku ata kryejnë veprimtarinë e tyre shkencore, si dhe të kuptuarin e problematikave dhe nevojave reale që ata kanë. "Një përfaqësi e përbërë nga dr. Belfjore Qose, dr. Ledia Vasjari dhe dr. Jonilda Llupo patën mundësinë të prezantojnë ARSH-në në Universitetin e Gjirokastrës, gjatë konferencës ndërkombëtare "Parku kombëtar i Vjosës - Dialogu i shkencës, kulturës dhe zhvillimit të qëndrueshëm", thuhet nga Akademia e të Rinjve. Sipas akademisë, rektori i UOGJ-së, prof. dr. Bekdash Mema ishte dashamirës ndaj kërkesës që ky aktivitet të realizohej. Akademia e të Rinjve shpreson që përmes këtyre prezantimeve dhe diskutimeve dinamike, të realizojë një adresim sa më të mirë të kërkesave të akademikëve të rinj. "Të njohim komunitetin e shkencëtarëve të rinj, të nisim bashkëpunime e projekte të reja, si dhe të frymëzojmë sa më shumë të rinj për të ndjekur rrugën e bukur të shkencës", thuhet nga AR. ALLEA ka miratuar një "Kartë të re themelore" si rregullatore njësuere e mënyrës së ngritjes dhe funksionimit të Akademive të Rinjve, e cila, me disa përshtatje, është miratuar nga Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë si statut i saj. Në ligj dhe në statut ka parashikime detyruese si duhet të ndërtohet dhe funksionojë Akademia e të Rinjve.



Finalizimi i akt-marrëveshjeve në fushën e arkeologjisë

■ Akt-marrëveshje monitorimi, sondazhesh dhe gërmimi arkeologjik janë finalizuar gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore një ditë më parë bëri me dije dhe sa akt-marrëveshje janë finalizuar. "+185 për qind akt-marrëveshje monitorimi, sondazhesh dhe gërmimi arkeologjik të finalizuara në 6 mujorin e parë të vitit 2024 krahasuar me vitin 2023", thuhet nga IKTK, që luan rolin

e mbikëqyrësit në terren me qëllim ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) është institucion në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i krijuar nga ligji nr.27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", dhe vendim Nr. 364, datë 29.5.2019 "Për Funkcionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së IKTK".

Gulielm Radoja, një aktor me një profil tejet të veçantë

■ Teatri "Aleksandër Moisiu" në Durrës kujtoi në ditën e tij të lindjes, artistin e mirënjohur të skenës dhe ekranit Gulielm Radoja, "Artist i Merituar", "Mjeshtër i Madh". Gulielm Radoja u lind në 2 korrik të vitit 1945 në qytetin e Shkodrës. Pas përfundimit të studimeve të larta në Institutin e Lartë të Arteve në vitin 1972, fillon punën si aktor profesionist në teatrin e Librazhdit. Më pas largohet nga ky teatër për të punuar si aktor dhe

regjisor pranë teatrit "Bylis" të qytetit të Fierit dhe më pas si aktor në teatrin "Aleksandër Moisiu" për t'u rikthyer në Teatrin Kombëtar në vitin 1996. Teatri shprehet se krahas interpretimeve të spikatura në teatër, Radoja pati një veprimtari të shkëlqyer edhe në kinematografi ku interpretoi në rreth 40 filma. "Ai ishte një aktor me një profil tejet të veçantë, sepse diti të ndërtojë karaktere mjaft të spikatur", thuhet nga teatri i Durrësit.

Gonxhja: Qershorin e mbyllëm me marrëveshje të rëndësishme

■ Në muajin që lamë pas nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit janë realizuar marrëveshje që ministri Blendi Gonxhja cilëson të rëndësishme. Ministri Gonxhja shprehet në rrjete sociale se gjithashtu pati dhe takime me drejtues të UNESCO-s. "E mbyllëm muajin qershor me marrëveshje dhe arritje të rëndësishme në fushat kryesore të MEKI. Raporti i OECD për Konkurrueshmërinë 2024 e vendos Shqipërinë si lider

në Ballkanin Perëndimor, me përmirësime në 13 nga 15 dimensione kyçe, përfshirë politikën e punësimit, turizmit dhe tregtisë. Zhvilluam takime intensive me nivelin e lartë drejtues të UNESCO, ku pala shqiptare u vlerësua për të gjithë gatishmërinë dhe punën e bërë, në mbrojtje të trashëgimisë kulturore", shprehet Gonxhja ndër të tjera, që ka publikuar dhe ditarin mujor të përmbledhur të MEKI-t.

kulturë

Dua Lipa qershorin që vjen një koncert në stadiumin "Wembley"

Këngëtarja Dua Lipa ka parajlmëruar se do të mbajë koncert në stadiumin e famshëm në Londër, "Wembley" më 20 qershor të vitit të ardhshëm. Pas gëzimit që përjetoi pasi u shfaq në skenën "Pyramid" të festivalit të mirënjohur Glastonbury, ajo dha lajmin se do të mbajë koncert në stadiumin, i cili ka kapacitet për 90 mijë persona. "Nuk do të ketë kohë më të

mirë për ta ndarë këtë lajm, pasi ende jam duke fluturuar pasi performova në Glastonbury, por jam e entuziazmuar të jap lajmin se do të performoj në stadiumin Wembley vitin tjetër", shkruan Lipa në rrjetet sociale. Biletat do të dalin në shitje më 12 korrik. Më parë Lipa pati thënë se e kishte ëndërruar të performonte në skenën "Pyramid" të Glastonburyt. "Kur e pata

shkruar në një letër, pata thënë se me të vërtetë dua të performoj në "Pyramid" të Glastonburyt në një të premtë mbrëma në mënyrë që të festoj dy ditët e ardhshme në vendin më të mirë në tokë", pati thënë Dua. Albumi i saj i ri "Radical Optimism", për një javë qëndroi në vendin e parë në toplistën britanike të albumeve më herët gjatë këtij viti.



FJALEKRYQI SOT

1	2	3		4	5	6		7	8	9	10		11
12			13				14						
15			16				17					18	
	19				20					21			
	22				23					24			
25				26					27				
28			29					30					31
32			33					34					35
		36						37				38	
39						40					41		

HORIZONTAL

1- Moment 4- Thikë në të dy anët e mprehur 7- Land në Gjermani 12- Vasili, gazetare 13- "Më mirë ai se sa nami", thotë populli 14- Fshehtas 15- Filiz i njomë që del nga trangu i pemës 17- Njëllor si delikatesë 18- Energji Natyrore 19- Dokument që identifikon pasurinë 20- Magazinat 21- Një numër 22- Pëlhurë që përdoret për të bërë çarçafë 23- Një fshat shumë afër Tiranës 24- Një perime vjeshte 25- Vegël pune e axhustatorit 26- Lëndë artificiale që përdoret në vend të lëkurës për valixhe 27- Copëz dheu që del nga punimi i tokës 28- Ish volejbollistja Babuli 29- Banorë të një krahine në jug të vendit, shumës 30- Ato të Gjergj Elez Alisë, i pashquar 32- Përemër vetor 33- Ka edhe një lloj vaji të tillë për motorat 34- Qytet në Kosovë 36- Guri i mullirit 37- Ka për kryeqytet Ukraina 38- Patrioti ... Pjetër Gega 39- Fletore 40- Vagabond, njeri imoral 41- "... e Forsajtëve" një roman trilogji nga novelisti Xhon Gollsuorth.

VERTIKAL

1- Shkrimtari i nderuar Zija ... 2- Agjensia e lajmeve greke 3- Rendi shoqëror, formë e organizimit të shoqërisë së një shteti 4- Frederik e Zhloi ... shkencëtar francez 5- Ngastër e mbjellë 6- Notë në pentagram 7- Shprehje algjebrike me dy terma të bashkuara me shenjat plus ose minus 8- Qoshet 9- Njëllor si zakon apo huq 10- Asistencë sociale 11- Drejtimi, kahu, mbrapsht 13- Konstruksione betoni që përdoren për ndërtim 14- Janë si veçori dalluese 16- E porsa bërë, e freskët 17- Mjet ndriçimi 18- Ramazoti e këngës italiane 20- Një qytet në verilindje të vendit 21- Ëmbëlsirë me peta në formë trekëndëshi 22- Lloj vinçi lundruar me dy krahë 23- Njeri me teka në të ngrënë dhe në të veshur 24- I moshuar 25- Djall, shejtan 26- Ish futbollist gjerman Rudi 27- Komunë e madhe në Mal të Zi, kufi me Shqipërinë 29- Një nënë nga krahinat e veriut 30- Shkencëtari francez ... Kyri 31- Rikardo ... ish futbollist brazilian që ka luajtur me Realin 33- Dita që jemi sot 34- Aktori amerikan Riçard ... 35- Barelë primitive 36- Fatmiri i politikës në inic 37- Korça në makina.

SUDOKU

				2														7					8	9
	9	3									5					6	3					2		1
2	1		5					8			7		9		1				6	7	4			
			6					3	4		2					8			3		9		7	2
					8			2	8	3					5	4			7	3				4
7	6		9	3		4	1				3			7	6	2		9				6	1	8
1				5	6				6		3		8			7	1			4		7	2	9
8	5		1			3	6	2		8		9	3	5		1	4			5	2	8		
	2		3	8	9		7			5		7	1			4		5						8

Këpucët legjendare të këngëtarit Elvis Presley shiten në ankand

Një koleksionist amerikan bleu 140 mijë euro këpucët legjendare blu të Elvis Presley-t. Këpucët, të veshura nga ikona e 'rock 'n' roll'-it gjatë viteve 1950, u blenë nga një koleksionist amerikan me bazë në Kaliforni të premtën, sipas shtëpisë së ankandit "Henry Aldridge & Son", e cila organizoi shitjen. Drejtuesi i ankandit, Andree Aldridge, duke folur për "Good Morning America" theksoi rëndësinë e shitjes, duke thënë se çmimi për të pasqyron rëndësinë e një objekti të tillë ikonik. Këngëtari Elvis Presley thuhet se ka veshur këto këpucë ikonë blu kamoshi si në skenë ashtu edhe jashtë saj gjatë viteve 1950. Ato fituan famë të veçantë gjatë paraqitjes së Presley-t në shfaqjen e Steve Allen më 1 korrik 1956, kur ai i përmendi përpara se të performonte "I want You, I Need You, I Love You".



Receta

Një burrë i moshuar drejtohet tek mjeku për problemet e tij shëndetësore. Sapo hapet dera mjeku e vështron plakun dhe i drejtohet duke i thënë:
 -Nga se vuani zotëri?
 Burri i moshuar heq syzet, i vendos mbi tavolinë dhe i thotë tepër i shqetësuar doktorit:
 -Doktor, të lutem më ndihmoni sepse nga njëri sy nuk arrij të shoh qartë?
 Mjeku afrohet dhe e pyet:
 -Më falni sa vjeç jeni ju zotëri?
 Burri tregon moshën reale të tij:
 -92 vjeç.
 Më pas mjeku duke mos i dhënë asnjë recetë i thotë:
 -Po, mjaft keni parë deri tani me të dy sytë, zotëri, tani mund të shihni edhe vetëm me njërin sy.

Holanda shkatërron Rumaninë, Turqia thyen Austrinë dhe përplasjet në çerekfinale me "tulipanët"

Holandezët fituan 3-0 dhe siguruan kalimin në 8-shen më të mirë, kurse turqit fituan në darkë ndaj austriakëve me rezultatin 2-1, në një ndeshje të fortë dhe emocionuese deri në sekondën e fundit

Adriatik BALLA

D uelet e fundit në 1/8 e finales u zhvilluan ditën e djeshme, ku pati edhe surpriza të bukura. Nuk munguan golat e bukur e të shpejtë, por edhe befasishtë, pasi Holanda u rikthye frikshëm në garë dhe Turqia bëri befasinë e madhe përballë Austrisë. Turqit e drejtuar nga Vincenzo Montela ia dolën të triumfojnë me rezultatin 2-1 ndaj Austrisë, në një sfidë ku hero ishte Merih Demiral. Qendërmbrojtësi zhbllkoi sfidën që në minutën e parë, duke shënuar pas një rrëmuje në zonë saktësisht në sekondën e 57-të, në atë që ishte edhe goli më i shpejtë i shënuar në një ndeshje të fazës me eliminim direkt të Europianit. Në pjesën e dytë Demiral shënoi sërish pas një krosimi nga këndi, duke dyfishuar avantazhin e turqve, por vetëm për 6 minuta, pasi Gregoritsch



rihapi sfidën sërish me kokë, pas zhvillimeve të një goditjeje nga këndi. Pjesa e mbetur e ndeshjes ishte vërtetë e luftuar, e hapur dhe me shumë raste, teksa në sekondat e fundit u desh mrekullua e portierit turk Gunok, për të çuar skuadrën e tij në fazën çerekfinale, aty ku do të përballlet me Holandën. Kampionati Europian do të rikthehet të premten e 5 korrikut me dy sfidat e para çerekfinale, Gjermani-Spanjë dhe

Francë-Portugali, ndërsa një ditë më vonë do të luhen përballjen Holandë-Turqi dhe Angli-Zvicër. Holanda zhvilloi dje një nga ndeshjet më të mira të saj ndër vitet e fundit, duke u dëshmuar se po rritet në rang ndërkombëtar. Kjo pasi Holanda triumfoi 0-3 ndaj Rumanisë, me skuadrën e Koeman që zhvilloi një ndeshje shumë të mirë, duke dominuar kundërshtarin. Pjesa e parë u mbyll me avantazhin minimal 0-1 falë

golit të Gakpo në minutën e 20-të, me 25-vjeçarin që realizoi një gol shumë të bukur nga distanca dhe jo vetëm, por konfirmoi momentin e mirë që pokalon pasi ky ishte goli i tretë në këtë Europian. Rezultati mund të kishte ndryshuar nëse Depay dhe Simons do të ishin treguar më të saktë para portës rumune. Në pjesën e dytë, sulmuesi i Liverpool realizoi edhe golin e dytë, por këtë herë, në minutën e 63-të Gakpo ishte në pozicion të parregullt. Gjithsesi, Rumania nuk ia doli të reagojë dhe Gakpo ishte sërish protagonist, këtë herë me një asist për Malen, me këtë të fundit që realizoi golin e dytë në minutën e 83-të. Sulmuesi i Dortmundit realizoi edhe golin e tretë në minutën e tretë të shtesës duke kapituluar Rumaninë që embyll këtu aventurën. Në krahun tjetër, Holanda fiton dhe çon sinjale të forta për rivalët e saj, ndërsa rikthehet në çerekfinale të Europianit pas plot 16 vjetësh.

Sulmuesi/ Nuk gjeti hapësirë në fushë, Koman largohet nga grumbullimi francez


Europiani ka hyrë në një fazë seleksionimi të më të mirëve, ku rezultati përcakton futuesit. Franca ka siguruar 8-shen, por s'po shfaq madhështi. Ndërkohë, në radhët e klubit ka tensione që lidhen me sa duket me minutazhin e mangët për disa lojtarë. Kështu, Kingsli Koman është larguar nga kampi i Francës pas kualifikimit në çerekfinale të Euro 2024, ka konfirmuar federata franceze. Koman ka pasur pak hapësirë te Franca në Evropian.

Lojtari i krahut kishte një lëndim në fund të edicionit dhe nuk është në gjendje më të mirë fizike. Por, ndonëse Osmane Dembele po shfaq pak, Koman nuk ka pasur shansin e tij të vërtetë. Koman ka udhëtuar për në Suedi që të jetë afër gruas së tij. Çifti është në pritje të fëmijës së katërt. Nuk është bërë e ditur se kur lojtari i Bajernit do të kthehet në përfaqësuese. Franca luan të premten në çerekfinale ndaj Portugalisë.



DEKLARATA

Ronaldo:
Pata lot, por dorëzimi nuk ndodh me mua



Kristiano Ronaldo ka reaguar për lotët gjatë ndeshjes së Portugalisë kundër Sllovenisë në Euro 2024 dhe shënimit të penaltisë në fund. I ka quajtur "momente të pashpjegueshme". 39-vjeçari shpërtheu në lot në mes të dy pjesëve të vazhdimeve dhe u ngushëllua nga bashkëlojtarët. Megjithatë, pas vazhdimeve ai e shënoi penalltinë e parë teksa Diogo Kosta i priti

të tri penalltitë e sllovenëve dhe Portugalia fitoi 3:0 për të kaluar në çerekfinale. "Edhe njerëzit më të fortë kanë ditë të këqija. Isha krejt në fund, kur skuadra kishte nevojë për mua më së shumti. Isha i mërzitur fillimisht, por tani jam i lumtur. Ky është futbolli. Momente të pashpjegueshme. Nuk e kam humbur asnjë penallti gjithë vitin. Në atë moment e humba, por gjëja

më e rëndësishme ishte se ekipi fitoi. Gjithmonë do të jap më të mirën që mundem për këtë fanellë, qoftë nëse dështoj ose jo, por duhet të marr përgjegjësinë kur ekipi ka nevojë. Nuk jam frikësuar kurrë të përballlem. Nganjëherë i bëj gjërat si duhet, nganjëherë jo, por për dorëzim s'mund të dëgjoni kurrë nga unë", u shpreh 39-vjeçari Cristiano Ronaldo.

MERKATO

Totenhemi blen një 18-vjeçar për sezonin e ri

Arshie Grej është lojtari më i ri i Totenhemit. 18-vjeçari shkëlqeu sezonin e kaluar me Lids, duke luajtur në 47 ndeshje. Mesfushori, i cili ka luajtur me të gjitha skuadrat e moshave të Anglisë, u prezantua dje nga "Spurs", të cilët besojnë se Grej është lojtari i së ardhmes. 41.25 mln euro shpenzoi Tottenham për të marrë shërbimet e 18-vjeçarit, i cili ka nënshkruar një kontratë që e mban të lidhur me londinezët deri në verën e vitit 2030.




Arshi Grej është formuar si futbollist tek Lids, por i mjaftoi vetëm një sezon në Championship për të treguar vlerat e tij.

MESFUSHORI

De Light kërkohet në Premier League, e do Junajtid

Me shumë mundësi e ardhmja Mathijs de Ligt do të jetë te Manchester Junajtid. Ditët e fundit, sipas raportimeve të medieve britanike "Djajtë e kuq" kanë kontaktuar me përfaqësuesit e mbrojtësit të Bayern Munichut dhe tashmë lojtari është më afër këtij transferimi, pasi ka marrë një ofertë të konsiderueshme financiare. Manchester Junajtid i ka ofruar holandezit një kontratë 5-vjeçare me terma financiare shumë tunduese.



Mbetet të shihet nëse lëvizja do të realizohet Brenda merkatos së verës apo mbetet projekt i së ardhmes për Manchester Junajtid.

QËNDRIMI

Morata: Do të rri te Atletiko deri sa të fitoj trofe

Alvaro Morata do të qëndrojë te Atletiko Madrid sezonin e ardhshëm. Këtë lajm e konfirmoi vetë sulmuesi spanjoll në një postim në rrjetet sociale, ku thekson se ka qëllim që të arrijë suksese me fanellën e "colchoneros". "Nuk mund ta imagjinoj se si duhet të jetë të fitosh trofe me këtë fanellë dhe do të fitoj. Nuk do ndaloj derisa të kem sukses", tha 31-vjeçari. Një deklaratë e qartë dashurie ndaj një skuadre me të cilën nuk ka ngritur ende një trofe,



një rast unik i karrierës së Moratës, i cili ka pasur sukses me fanellat e Real Madridit, Juventusit dhe Çelsit.